



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**BASHKINË LEZHË**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**  
**“AUDITIM FINANCIAR MBI VEPRIMTARINË E BASHKISË LEZHË”**

**TIRANË, 2025**

## Përmbajtja

<b>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....</b>	<b>3</b>
a. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.....	3
b. Objektivat dhe qëllimi i auditimit:.....	4
c. Metodatat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:.....	4
d. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve.....	4
<b>KONKLUZIONI I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT .....</b>	<b>6</b>
<b>II. HYRJE .....</b>	<b>7</b>
1. Objektivat dhe qëllimi.....	7
2. Identifikimi i çështjes: .....	7
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar: .....	7
4. Përgjegjësia e audituesve të KLSH:.....	8
5. Kriteret e vlerësimit: .....	8
6. Standardet e auditimit .....	9
7. Metodologjia e auditimit .....	9
8. Dokumentimi i rezultateve të auditimit:.....	10
<b>III. PËRSHKRIM I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT .....</b>	<b>10</b>
1. MENAXHIMI FINANCIAR DHE KONTROLLI I BRENDSHËM.....	11
2. AUDITIM MBI PLANIFIKIMIN, ZBATIMIN DHE MONITORIMIN E PLANIT TË BUXHETIT .....	24
3. AUDITIM MBI VLERËSIMIN E RAPORTIMIT FINANCIAR, PËR TË ARRITUR NË OPINIONIN NË SE PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN 2022, JAPIN NJË PARAQITJE TË VËRTETË E TË DREJTË TË POZICIONIT FINANCIAR, PERFORMANCËS FINANCIARE DHE FLUKSIT TË PARASË, BAZUAR NË KUADRIN RREGULLATOR NË FUQI .....	40
4. AUDITIM MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E STRUKTURAVE MBI ADMINISTRIMIN E PRONËS PUBLIKE (ASETE DHE PYJE E KULLOTA) TË TRASNFERUARA SIPAS VKM. ....	55
5. TË NDRYSHME TË DALA GJATË AUDITIMIT - ANKESË.....	59
<b>III. GJETJE DHE REKOMANDIME.....</b>	<b>60</b>
A. MASA ORGANIZATIVE.....	60
B. MASA PËR RRITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE.....	66
C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, SI DHE NGA QIRADHËNIA, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH.....	67
D. MASA DISIPLINORE.....	68

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Nga auditimi financiar i ushtruar në Bashkinë Lezhë për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023, në mënyrë të përmbledhur u konstatuan mangësitë si vijon:

- Lidhur me saktësinë e raportimit financiar, nga Drejtoria e Financës janë kryer veprime mbi pasqyrimin e ngjarjeve ekonomike në kontabilitet në mënyrë jo të drejtë:  
Në datë 31.12.2023 Llogaria 101 “Teprica” është pasqyruar për vlerën 6,085,647,215 lekë. Sipas analizës së mësipërme llogaria 101 është raportuar në bilanc e mbivlerësuar për vlerën 825,112 lekë;  
Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” është mbivlerësuar për vlerën 25,108,199 lekë e cila përbëhet prej 17 faturave tatimore për mallra. Këto fatura janë regjistruar në llogarinë 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”;  
Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Lezhë, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 165,278,352 lekë. Kontabilizimi i detyrimeve të prapambetura në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” nuk kryhet në këtë llogari. Sipas analizës së mësipërme llogaria 486 është raportuar në bilanc e mbivlerësuar për vlerën 165,278,352 lekë.
- Lidhur me administrimin e aseteve, Bashkia Lezhë ka marrë masa dhe ka regjistruar e pajisur me certifikatë në ZVRPP Lezhë 539 asete ose 12% të aseteve që i janë transferuar. Për asetet e mbetura, nuk kryhet një inventarizim periodik, duke mos patur informacion as për gjendjen e tyre, nëse janë ende ekzistente, të zaptuara, privatizuara, etj. Për këto asete nuk ka një pasqyrimin real dhe të drejtë të vlerës së tyre në pasqyrat financiare, nuk ka një vlerësimin fizik, identifikim të mangësive apo humbjeve, si dhe krijimin e regjistrit kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë.
- Sa i takon planifikimit dhe realizimit të të ardhurave, vlera debitore në fund të 2023 është 278,035,252 lekë, që përbën detyrim për arkëtim, duke qenë se e gjithë vlera e mësipërme është njohur dhe kontabilizuar. Ndërkohë që rezultojnë të ardhura të munguara nga taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 6,353,096 lekë, vlerë e cila nuk është dërguar pranë Drejtorisë së Financës për njohje dhe kontabilizim.

### **Përshkrim i shkurtër i institucionit**

Bashkia Lezhë është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”, Rregulloren e funksionimit të Bashkisë dhe akteve të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Lezhë. Për vitin 2023 në Bashkinë Lezhë buxheti është hartuar kryesisht mbi bazën e 20 programeve, përkatësisht: Aparati, Shërbimi Policor, MZSh, Zhvillimi Ekonomik, Shërbimi Bujqësor, Bordi Kullimit, Administrimi i Pyjeve, Menaxhimi i Mbetjeve, Planifikimi Urban Vendor, Shërbimi Publik Vendor, Qendra Kulturore, Arsimi Bazë, Arsimi Mesëm, etj.

#### **a. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.**

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “Auditi i jashtëm” pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: *“1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësisve të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë”*. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se,

Bashkia Lezhë si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim finanacimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

**b. Objektivat dhe qëllimi i auditimit:**

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Lezhë. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme

- mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit.
- mbi funksionimin e kontrollit të brendshëm financiar.
- mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave.
- mbi shqyrtimin dhe dhënien e opinionit në përgatitjen e pasyrave financiare.
- mbi administrimin e pronës publike.

**c. Metodatat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:**

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera me qëllim arrijen e objektivave të auditimit.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

- Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;
- Raportet dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimit e auditimit;
- Verifikimi në sistemin elektronik* - me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;
- Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

**d. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve**

Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se Bashkia Lezhë për periudhën nën auditimit paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë, për të cilat grupi i auditimit ka konstatuar 15 gjetje dhe janë lënë 16 rekomandime. Në vijim paraqiten ato më kryesoret:

**e. Gjetjet kryesore:**

- Për përlllogaritjen e vështirësisë financiar, Bashkia Lezhë ka raportuar si shpenzime vjetore faktike vlerën prej 1,875,828 mijë lekë që në fakt është vlera e shpenzimeve të planifikuara dhe jo e atyre faktike, gjë që e nxjerr këtë Bashki në nivele vështirësie më të ulta se sa është realisht.
- Bashkia Lezhë zotëron në total 4473 asete, nga të cilat për 677 raste është miratuar lista përfundimtare, ndërkohë pjesa e mbetur janë në fazë paraprake. Nga lista e aseteve të transferuara, rezulton se Bashkia Lezhë ka marrë masa dhe ka regjistruar e pajisur me certifikatë në ZVRPP Lezhë 539 asete ose 12% të aseteve. Për asetet e mbetura, nuk kryhet një inventarizim periodik, duke mos patur informacion as për gjendjen e tyre, nëse janë ende ekzistente, të zaptuara, privatizuara, etj.

- Llogaria 467 “Kreditore të ndryshëm”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Lezhë, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 165,278,352 lekë dhe përfaqëson vlerën e detyrimeve të Bashkisë Lezhë për kontratat e investimeve. Gjatë vitit 2023 kjo llogari është shtuar me vlerën 75,447,313 lekë. Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” është mbivlerësuar për vlerën 33,615,932 lekë e cila përbëhet prej 8 faturave tatimore për mallra. Këto fatura janë regjistruar në llogarinë 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”, Regjistrimi në llogarinë 467 ka sjell pasqyrim jo real të llogarive kontabël.
- Nga auditimi i kontratave të qirave rezulton se për përcaktimin e vlerës është marrë çmimi për dhënien e sipërfaqes pyjore prej 76,800 lekë, vlerë e cila i korrespondon kategorisë 9, për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objektesh të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe, ndërkohë që për këtë përlllogaritje, çmimi duhet ti referohej kategorisë 8, për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linje të tensionit, *aerogjeneratorë (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj)*, në vlerën 150,000 lekë, pasi objekti i kontratës bën fjalë për ngritje impianti dhe jo zbulim elementësh. Përlllogaritja e saktë e vlerës së sipërfaqes duhej të ishte  $1\text{ha} \times 150,000\text{lek/ha/vit} \times 2\text{vjet} = 300,000\text{lekë}$  dhe vlera totale e kontratës 422,000 lekë ose 146,400 lekë më tepër se sa është përlllogaritur.
- vlera totale debitore në fund të vitit 2022 është 246,341,820 lekë. Vlera e krijuar bashkë me kamatëvonesat gjatë vitit 2023 është 252,101,243 lekë, ndërkohë që janë arkëtuar detyrime në vlerën 220,407,811 lekë, nga ku rezulton se vlera debitore në fund të 2023 është 278,035,252 lekë, që përbën detyrim për arkëtim, duke qenë se e gjithë vlera e mësipërme është njohur dhe kontabilizuar.

**f. Rekomandimet më kryesore** për përmirësimin e situatës lidhen me sistemimet përkatëse në llogaritë kontabël për mangësitë e konstatuara, masat për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, si dhe ato për arkëtimin e debitorëve nga taksat dhe tarifave vendore si vijon:

- Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Lezhë, të marrë masa për nënshkrimin e marrëveshjeve me agjentët e ndryshëm tatimorë, si dhe verifikimet në terren për identifikimin e bizneseve dhe familjarëve që kanë detyrime tatimore, duke krijuar një data bazë të detajuar me të dhëna për llojet e detyrimeve dhe vlerat e tyre vit pas viti.
- Nga sektori juridik në Bashkinë Lezhë, të merren masa për rishikimin dhe saktësimin e vlerës totale të kontratës nr. 2733/2, datë 19.04.2022, sipas kategorisë 8, për ndërtim aerogjeneratorë (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatësej), si dhe arkëtimin e diferencës prej 146,400 lekë nga mos përlllogaritja e saktë e kësaj vlere.
- Masa për sistemimet dhe korrigjimet në llogaritë përkatëse kontabël të zërave të konstatuar me mangësi
- Titullari i Bashkisë Lezhë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për identifikimin e gjendjes së aseteve të mbetura pa regjistruar të cilat i janë transferuar në pronësi në mënyrë përfundimtare, si dhe të fillojë përgatitja e dokumentacionit tekniko ligjor të secilit prej tyre për të vijuar me aplikimet përkatëse për pajisje me çertifikatë pronësie.
- Sektori i hartimit dhe zbatimit të buxhetit, të marrë masa që në të ardhmen, në përlllogaritjen e treguesit të vështirësisë financiare të Bashkisë, të aplikojë vlerën e shpenzimeve faktike dhe jo atyre të planifikuara.

## **KONKLuzioni I PëRGJITHSHëm DHE OPINIONI I AUDITIMIT**

### **Për auditimin e pasqyrave financiare:**

Ne kemi audituar, pasqyrat financiare individuale të Bashkisë Lezhë për vitin e fundit ushtrimor 01.01.2023 - 31.12.2023, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyra e flukseve të mjeteve monetare, pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Lezhë janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionin *të modifikuar, me rezervë*, e shprehur kjo në bazën për opinionin.

### **Baza për opinionin e modifikuar me rezervë:**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë (ISA 700-ISSAI 1700).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura (ISA 705-ISSAI 1705). Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 është 10,873 mijë lekë.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se:

Gabimet materiale në pasqyrat financiare të mbyllura në 31 dhjetor 2023, paraqiten si më poshtë: Nga Drejtoria e Financës janë kryer veprime mbi pasqyrimin e ngjarjeve ekonomike në kontabilitet në mënyrë jo të drejtë, kryesisht:

-Llogaria 101 "Teprica" është regjistruar në datë 01.01.2023 për vlerën 6,328,164,500 lekë, gjatë vitit 2023 ka pasur shtesa në vlerën 85,795,020 lekë nga investimet dhe dhurimet, pakësimet kanë qënë në vlerën 326,340,660 lekë nga amortizimi i vitit dhe nxjerrjet nga përdorimi. Në datë 31.12.2023 kjo llogari është pasqyruar për vlerën 6,085,647,215 lekë.

Sipas analizës së mësipërme llogaria 101 është raportuar në bilanc e mbivlerësuar për vlerën 825,112 lekë

-Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm" është mbivlerësuar për vlerën 25,108,199 lekë e cila përbëhet prej 17 faturave tatimore për mallra. Këto fatura janë regjistruar në llogarinë 401-408 "Furnitorë dhe llogari të lidhura me to".

-Llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme", sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Lezhë, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 165,278,352 lekë. Kontabilizimi i detyrimeve të prapambetura në llogarinë 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" nuk kryhet në këtë llogarinë, Sipas analizës së mësipërme llogaria 486 është raportuar në bilanc e mbivlerësuar për vlerën 165,278,352 lekë.

## **II. HYRJE**

Mbështetur në ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 1083/1 Prot, datë 11.09.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 11.09.2024 deri më datë 11.10.2024 në subjektin Bashkia Lezhë, u krye auditimi financiar për periudhën 01.01.2023 deri 31.12.2023, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. R. K., Përgjegjëse grupi
2. E. K., Audituese
3. E. S., Audituese
4. K. H., Auditues

### **1. Objektivat dhe qëllimi**

Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2023, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

### **2. Identifikimi i çështjes:**

Raporti i auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit dhe të përgjegjësive të titullarëve dhe stafeve mbështetëse për realizimin e përgjegjësive publike.

Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ, çështjet e vlerësuara i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, në funksion të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë së këtij institucioni publik, transparencës, përgjegjësisë dhe logaritimit.

Raporti i Auditimit është i strukturuar në disa kapituj ku identifikohet hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimin e auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve, kriteret, përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej drejtimeve të auditimit; përfshirë dhe gjetjet e rekomandimet së bashku me anekset.

### **3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar:**

Titullari i Bashkisë, dhe Nëpunësi Zbatues sipas rastit, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrin ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH”, i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, etj. Gjithashtu, stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

#### **4. Përgjegjësia e audituesve të KLSH:**

Përgjegjësia e audituesve është dhënia e opinionit mbi problematikat e trajtuara të çështjeve nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar me objekt: dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord. Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Bashkisë, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Gjatë kryerjes së auditimit, audituesit e KLSH marrin evidenca të besueshme, të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të mbështetur gjykimin dhe konkluzionet e dala lidhur me organizimin, veprimtarinë, programin dhe funksionet e subjekteve nën auditim. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojnë.

#### **5. Kriteret e vlerësimit:**

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:

Ligji nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

Ligji nr. 84/2023 “Për buxhetin e vitit 2023” dhe aktet normative që ndryshojnë këtë ligj.

Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”

Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, i ndryshuar;

VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”;

Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 35, datë 5.11.2008 “Për zbatimin e ligjit nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore”;

Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”;

UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, etj.;

Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar;

Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”;

Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014.

Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”;

Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”;

Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:

Ligji nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar me ligjin nr. 9477 datë 9.2.2006”;

VKM nr. 248, date 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001;

VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”;



VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”;

Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, etj.;

Udhëzimi përbashkët i Ministrisë së Çështjeve Vendore dhe Ministrisë së Financave nr. 3237, datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”.

*Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:*

Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”;

Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale”, i ndryshuar;

Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar

VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime;

VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”;

Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

## **6. Standardet e auditimit**

Për kryerjen e Auditimit Financiar në Bashkinë Lezhë grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë: - ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”; si dhe ISSAI 4200; - Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC.

## **7. Metodologjia e auditimit**

### 1. Kontrolli aritmetik

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).

### 2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. 3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël. 4. Kontrolli i vlerësimit Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë

të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre. 5. Konfirmim nga të tretët Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

### 3. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Tepelenë me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

### 4. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

## **8. Dokumentimi i rezultateve të auditimit:**

Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave dhe dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, si dhe intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me stafin, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykimit profesional, si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, intervistave etj., të finalizuara me akt-konstatimet, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti Auditimi. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e mbledhura gjatë auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur vlerësimet / përfundimet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tij.

## **III. PËRSHKRIM I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT**

Lezha kufizohet në veri me Bashkitë e Vaut të Dejës dhe Pukës, në perëndim me Detin Adriatik, në lindje me Bashkinë e Mirditës dhe në jug me Bashkinë Kurbin. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Lezhës. Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, Lezha ka 65,633 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 106,245 banorë. Me një sipërfaqe prej 509.1 km<sup>2</sup>, bashkia e re e Lezhës ka një densitet prej 208.69 banorë/km<sup>2</sup> sipas të dhënave të Regjistrimit Civil dhe 128.91 banorë/km<sup>2</sup> sipas Censurit 2011. Të dhëna të tjera: Bashkia e Lezhës shtrihet në pjesën dërrmuese të vet në një zonë të ulët dhe bregdetare, me lartësi 5 metra mbi nivelin e detit dhe përbëhet nga 10 Njesi Administrative (Lezhë, Shëngjin, Shënkoll, Zejmen, Kallmet, Dajç, Blinisht, Balldre, Kolsh, Ungrej). Trashëgimia e pasur historike dhe kulturore e bën këtë bashki një destinacion tërheqës për turizmin kulturor. E shtrirë në të dy anët e lumit Drin, e rrethuar nga lagunat Kunë e Vain si dhe nga plazhi i bukur i Shëngjinit, Lezha ofron bukuri natyrore të larmishme dhe mundësi të shumta për zhvillimin e turizmit jo vetëm brenda territorit të saj, por edhe në një distancë të afërt. Aktualisht, ekonomia në qytet është e diversifikuar, por mbështetet në tregti dhe shërbime, sektorë që punësojnë numrin më të madh të banorëve të Lezhës.

## 1. MENAXHIMI FINANCIAR DHE KONTROLLI I BRENDSHËM

*Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi dhe Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë.*

Ky auditim u krye në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ndryshuar, si aktet ligjore e nënligjore dalë në zbatim të tij, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe si ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

### **I. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”:**

**Në lidhje me parimin 1** “Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”

- Bashkia Lezhë ka miratuar Rregulloren e Brendshme të Bashkisë me Vendimin nr. 393, nr. 12755/1 prot., datë, 18.07.2022, të Kryetarit të Bashkisë. Njohja e stafit me rregulloret dhe bazën ligjore në fuqi kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike sipas fushës dhe strukturave përkatëse nga Drejtoria Juridike, por nuk ka trajnime për këto raste.

*-Bashkia Lezhë nuk ka miratuar një Kod të Etikës, por në nenin 27 e në vijim të Rregullores së Brendshme të kësaj Bashkie , është përfshirë edhe “Etika për punonjësit e Bashkisë Lezhë dhe kodi i veshjes”.*

**Në lidhje me parimin 2** “Titullari demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje”

-Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësisë mbikëqyrëse që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxherial janë përcaktuar që në rregulloren e brendshme dhe veprohet në bazë të tij.

- Nga drejtoritë ka raporte periodike, mujore, për realizimin e të ardhurave të veta të Bashkisë Lezhë me format të miratuar, rakorduar me Drejtorinë e Tatim Taksave dhe Degën e Thesarit.

-Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA, si dhe janë dërguar në MFE.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka asnjë plan menaxhimi për veprime korigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Nga njësitë e varësisë ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë, ka dhe akt rakordime për realizimin e shpenzimeve gjatë muajve.

- Në bazë të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” nenin 19 dhe 29, dhe shkresave përkatëse të Ministrisë së Financave nga Bashkia është plotësuar dhe dërguar pranë Njësisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit pranë Ministrisë së Financave, “Pyetësori i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit

financiar dhe kontrollit dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”. Për vitin 2023 me shkresën nr. 2706 prot, datë 28.02.2024 është dërguar në Ministrinë e Financave raporti vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm dhe pyetëtori i vetëvlerësimit, gjithashtu është nënshkruar dhe deklarata e cilësisë. Titullari i Institucionit merr opinione për performancën e institucionit nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, nga Auditi i Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese si dhe nga Projekti i Bashkive të Forta.

-Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

**Në lidhje me parimin 3** “Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”.

- Në dokumentet e PBA-ve ka miratuar strategjinë me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me ligjin organik të buxhetit, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.

- Referuar kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve, për hartimin e planit strategjik, rezultoni se janë organizuar takime me palët e treta si me grupet e interesit nëpërmjet dëgjësive me publikun.

- Bashkia Lezhë për periudhën objekt auditimi ka hartuar dhe ka funksionuar me një rregullore të brendshme në përshtatje me strukturën organike, miratuar me Vendimin nr. 393, nr. 12755/1prot., datë, 18.07.2022, të Kryetarit të Bashkisë.

- Për periudhën objekt auditimi është miratuar struktura organizative në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e Bashkisë. Për vitin 2023 struktura është miratuar me Urdhër të Titullarit nr. 633 prot., datë 30.12.2022, me 820 punonjës bashkë me institucionet e varësisë dhe funksioneve të deleguara.

- Në Rregulloren e Brendshme janë për çdo Drejtori misioni, objektivat, baza ligjore, përbërja e strukturës, detyrat dhe përgjegjësitë për çdo drejtori, sektor dhe specialist. Ndërsa në dosjet e personelit janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion.

- Bashkia Lezhë ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet në të cilën janë paraqitur dokumentet e rëndësishme dhe informacione për njësitë vendore.

- Vlerësimin e punës së strukturës organike Bashkia e kryen nëpërmjet plotësimit të vetëvlerësimit, nëpërmjet raporteve të auditimit, të cilat në fakt janë të përputhshmërisë dhe nuk ka raporte performance.

**Në lidhje me parimin 4:** “Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”

- Me urdhërin nr.2 datë 06.01.2023 të Kryetarit të Bashkisë Lezhë “Për miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2023”, janë miratuar pozicionet që janë të hapura për konkurim në shërbimin civil gjatë vitit 2023. Pozicionet e punës janë pjesë e kategorisë ekzekutive, të ulët drejtuese dhe të mesme drejtuese. Plani i pranimeve ka ndryshuar gjatë vitit për shkak të dorëheqjes së nëpunësve civilë.

- Në lidhje me kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, me urdhërin nr.30 datë 27.01.2023 “Për miratimin e pozicioneve të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese të cilat do të jenë të hapura për konkurim dhe për pranim nga jashtë shërbimit civil”, janë miratuar pozicionet e kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, që janë të hapura për konkurim jashtë shërbimit civil. Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale, e cila përmban të dhëna të karakterit teknik, profesional, të dhënat për marrëdhëniet e punës, arsimin, rekrutimin, kualifikimin, trajnimin, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë. Dokumentet përkatës që vërteton pohimin e bërë si: certifikata e gjendjes familjare; diploma e shkollës së lartë, lista e notave; certifikatat ose diplomat e kualifikimeve ose të specializimeve; dëshmi të gjuhëve të huaja, të tjera.

-Bashkia Lezhë ka planifikuar në buxhet për vitin 2023 trajnimet e punonjësve. Nga Bashkia Lezhë është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime nga menaxheret e programeve dhe kjo tabelë i është dërguar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike. Gjithashtu punonjësit kanë kryer trajnime që janë në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike gjatë vitit 2023. Në kuptimin e filozofisë së menaxhimit dhe stilit të vepruarit nga menaxheri i njësisë, në njësi veprohet në bazë të detyrave të caktuara në rregullore dhe kërkesa e llogarisë organizohet sipas hierarkisë së organigramës të përcaktuar, duke realizuar mbikëqyrjen e punonjësve për kryerjen e detyrave. Përsa i përket politikave dhe praktikave të ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në rregullore janë përcaktuar detyrat sipas Drejtorive dhe Sektorëve dhe linjat e raportimit.

- *Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm” i cili përcakton se “Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm:*

- Nëpunësi zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin të përshtatur me pozicionin si Drejtor finance dhe buxheti .

**Në lidhje me parimin 5:** “Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale”.

Janë kryer delegime detyrash të cilat janë bërë në bazë të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 59, pika 3 me autorizimet dhe Urdhërat përkatës, kryesisht delegimi i funksioneve në rast të mungesës së nëpunësit autorizues.

- Në zbatim të ligjit organik të buxhetit ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008, dhe të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2019 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe udhëzimit të MFE nr. 7 , datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023 – 2025 Titullari i Bashkisë ka nxjerrë urdhra për ngritjen e GMS:

**Për vitin 2023** me urdhër nr. 35, datë 07.01.2022 është krijuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS-së) dhe Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP-ve) për përgatitjen e PBA-së 2023-2025, për Bashkinë Lezhë, i ndryshuar me Urdhërin nr.104, datë 15.03.2022.

- Janë vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar.

- Eshhtë dokumentuar procesi i paraqitjes së kërkesave buxhetore sipas programeve të Kryetari i Bashkisë . Përsa i përket dokumenteve të hartuara është bërë deklarami se si ka funksionuar në parim kontrolli i brendshëm në lidhje me realizimin e sistemeve të aktivitetit të Bashkisë: Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore; sistemi i programimit të zbatimit të buxhetit; sistemi i pagesave, sistemi i prokurimeve me vlera të vogla dhe të larta; inventarët e aktiveve të qëndrueshme e qarkulluese; sistemi i tatim-taksave.

Në kapitullin “Vlerësimi i sistemit të MFK” janë përshkruar se sa janë arritur objektivat në fushat prioritare për bashkinë si në sektorin e shërbimeve publike, sektorin e urbanistikës dhe sektorin e tatim-taksave. Si ka ndikuar komponenti i informimit dhe komunikimit me procedurat me rregulloret e hartuara dhe të realizuara nga kjo njësi në arritjen e objektivave në sektorët më të rëndësishëm të veprimtarisë së bashkisë. Si ka funksionuar komponenti i monitorimit të kontrollit të brendshëm në cilësinë e performancës. Si ka ndikuar veprimtaria e AB në monitorimin e Kontrollit të brendshëm.

Pjesë e Deklaratës duhet të jetë edhe fakti se si është realizuar ngritja dhe zbatimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, strukturat, programet, veprimtaritë dhe

proceset që menaxhohen prej nëpunësit autorizues, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të transparencës.

Kjo duhej realizuar nëpërmjet:

Monitorimit të veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe të rregullshmërinë duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit. Realizimit të “gjurmës së auditimit” që përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendim-marrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

Mbikëqyrjes së ndarjes së detyrave, caktimin e përgjegjësive, rishikimin sistematik dhe shprehjen e miratimit për punën e secilit punonjës në pika kritike, në mënyrë që të sigurohet se ajo është kryer sipas parashikimit. Udhëzimeve të dhëna dhe kryerjes së trajnimeve të nevojshme për punonjësit, për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe se direktivat e dhëna, të cilat duhet të kuptohen dhe të arrihen nga punonjësit.

## **II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”**

**Në lidhje me parimin 6:** Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me këto objektiva.

**Bashkia Lezhë** në hartimin e PBA-ve ka vendosur objektiva si në planet operationale strategjike, në planet vjetore të veprimtarisë, në planifikime në investimeve, në planet buxhetore vjetore, të cilat janë në përputhje me strategjitë dhe politikat kombëtare e sektoriale si dhe me vizionin dhe misionin e njësisë.

Përsa i përket regjistrimit të riskut rezulton se nga ana e bashkisë Lezhë nuk është hartuar regjistri i riskut. Në kundërshtim me ligjin nr .10 296, datë 8.7.2010 për “menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 11 dhe neni 12.

Sa më sipër konstatohet se, për periudhën objekt auditimi nuk ka një strategji të miratuar të riskut ku të përcaktohet mënyra se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet t’u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre. Këto mosveprime janë në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar ku citohet se: “Titullari i njësisë publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut”.

**Në lidhje me parimin 7:** “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”

**Në lidhje me parimin 8:** “Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime”

Duke mos patur një vlerësim të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. Në rregulloren e brendshme nuk janë përfshira detyrat dhe përgjegjësit e koordinatorit të riskut, dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe gjithëpërfshirës.

**Në lidhje me parimin 9:** “Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”.

Bashkia Lezhë në politikat dhe procedurat e veprimtarisë së saj ka marrë vazhdimisht në

konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni, apo nga ndryshimet në menaxhim, duke marrë masa për ti paraqitur rregullat e nevojshme në përputhje me ndryshimet në rregulloret e brendshme dhe duke përcaktuar apo deleguar e autorizuar detyrat në personat zëvendësues përgjegjës për realizimin e funksioneve të ndryshuara.

### **III. Komponenti: “ Aktivitetet e Kontrollit”**

**Në lidhje me parimin 10:** “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrollit”

- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë janë përcaktuar krahas detyrave dhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës të cilat i referohen edhe hartës së proceseve të punës të përcaktuara në dispozitat ligjore (si procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj.) jo të gjitha aktivitete e kontrollit janë të dokumentuara në formën e hartave të proceseve të punës .

- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Financës (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Përgjegjësi i financës/Autorizimi i pagesës nga Kryetari i Bashkisë (NA).

- Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit të komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i pranimit të mallit.

- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh.

- Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivitet Afatgjatë nuk janë regjistruara në SIFQ, pasi kjo Bashki akoma nuk është pilot për aplikimin direkt në programin e Qeverisë SIFQ.

**Në lidhje me parimin 11:**“Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”

- Bashkia Lezhë nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

Sektori i IT, i cili varet nga Drejtoria e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës, ka vetëm detyra për mirëmbajtjen e sistemit kompjuterik dhe menaxhimin e programeve, dhe merret me instalimin e programeve. Gjithashtu ka përgjegjësi dhe menaxhon Serverin kryesor, duke garantuar sigurinë e sistemit të IT në lidhje me ndryshimet e fjalëkalimeve, fireëall-et.

**Në lidhje me parimin 12:**“Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”

- Për aktivitetet e kontrollit janë përcaktuar përgjegjësitë si për drejtuesit dhe personelit tjetër të caktuar, përgjegjësi këto të identifikuar në rregulloren e brendshme dhe në veprimtarinë e përditshme të Bashkisë, por mungojnë plan-veprime të ndryshme operative dhe të menaxhimit të riskut.

- Bashkia Lezhë ka krijuar Njësinë e sinjalizimit e cila ka të përcaktuara në rregulloren e brendshme të institucionit procedurat anti-korrupsion dhe të sinjalizimit të parregullsisve. Nga evidencat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se për periudhën në auditim nuk janë ndërmarrë hapa konkrete sa i përket implementimit dhe funksionimit të kësaj njësie, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 17, pika 1.

-Bashkia Lezhë ka një procedurë të qartë lidhur me mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave dhe analizën e tyre, e cila bën të mundur identifikimin e shkaqeve dhe eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave. Në Bashkinë Lezhë ka përfunduar hartimi dhe miratimi i kësaj procedure por nuk janë marrë masa konkrete për implementimin e saj e më tej kontrollin e performancës, veprime këto në kundërshtim me, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4, pika 20.

-Bashkia Lezhë nuk ka hartuar, miratuar dhe arkivuar gjurmën e auditimit e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre dhe synon të ripërshkrojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to.

-Bashkia Lezhë ka një procedurë të qartë lidhur me mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave dhe analizën e tyre, e cila bën të mundur identifikimin e shkaqeve dhe eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave. Në Bashkinë Lezhë ka përfunduar hartimi dhe miratimi i kësaj procedure por nuk janë marrë masa konkrete për implementimin e saj e më tej kontrollin e performancës.

#### **IV. Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”**

##### **Në lidhje me parimin 13: “Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor”.**

Drejtuesit në Bashkinë Lezhë kanë identifikuar dhe përcaktuar informacionin e kërkuar nëpërmjet raportimit financiar dhe operacional, në nivelet përkatës dhe specifikat e duhura tek personeli i duhur.

Sistemi i raportimit ofron pjesërisht informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësisve të varësisë të saj.

- Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit hartohen çdo 4-mujor dhe vjetor dhe paraqiten pranë Këshillit Bashkiak si dhe në Ministrinë e Financave.

- Raportet për detyrimet e konstatuara por të papaguara hartohen çdo muaj dhe paraqiten në degën e thesarit.

- Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit në Bashkinë Lezhë për mbajtjen e kontabilitetit operon me program të vetin të kontabilitetit, pa e dubluar programin SIFQ. Në bazë të këtij programi kontabilitetit me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i shpenzimeve nga Drejtoria e finances dhe buxhetit . Ndërsa monitorimi i të ardhurave kryhet me program të veçantë të cilin e menaxhon Sektori i Tatim-Taksave.

##### **Në lidhje me parimin 14: Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm.**

##### **Në lidhje me parimin 15: Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm.**

Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, në nenin 11 “Bashkëpunimi ndërmjet strukturave të Administratës së Bashkisë”, neni 13 “Marrëdhëniet me Këshillin Bashkiak”, neni 21 “Informacioni dhe komunikimi me median”, neni 9 “Marrëdhëniet me publikun”.

Informacioni që sigurohet nga drejtuesit dhe përgjegjësit e sektorëve i transmetohet Titullarit për çdo muaj, i cili informohet mbi shpenzimet aktuale , të ardhurat e veta të realizuara dhe buxhetin



e planifikuar. Informacioni prej drejtuesve dhe përgjegjësve të sektorëve dërgohen çdo javë çdo muaj dhe nëpërmjet analizave të herëpashershëm sigurohet informacion për arritjen e objektivave dhe dëmeve të mundshme.

### **Komponenti: “Monitorimi”**

**Në lidhje me parimin 16:** “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”

- Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë

- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen e objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet çdo 4 muaj.

- Bashkia monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar çdo vit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave me shkresën nr. 2706 prot, datë 28.02.2024. Për vitin 2023 nga Bashkia Lezhë janë përgatitur 3 raporte për monitorimin e procesit të zbatimit të buxhetit. Raporti i monitorimit 4 mujorin e parë me nr. 6016/1 Prot, datë 31.05.2023, raporti i monitorimit për 4 mujorin e dytë 2023 me nr. 15031/1 Prot, datë 27.09.2023 dhe për 12 mujorin 2023 me nr. 1849 prot., datë 12.02.2023

- Në Bashkinë Lezhë mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

- Në Bashkinë Lezhë aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Planet e Menaxhimit dhe Raportet e Zbatimit, mungojnë Indikatorët e Performancës si dhe Komiteti i Auditimit.

- Një nga drejtimitet e monitorimit ka të bëjë me aktivitetin e Auditimit të Brendshëm.

Auditi i Brendshëm, është angazhuar për ndërmarrjen e masave korrigjuese, nëpërmjet planveprimet për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

**Në lidhje me parimin 17:** “Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”

- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura në sistemin e kontrollit të brendshëm nga Drejtuesit e Programeve janë bërë prezentë në mbledhjet periodike me Kryetaren e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

*Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi: Drejtori i Finances dhe Mmenaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Brendshëm znj. B. V..*

### ***Mbi funksionimin e njësisë së Auditit të Brendshëm***

Njësia e Auditit të Brendshëm për vitin 2023 ka funksionuar me 3 (tre) Auditues, një përgjegjës Sektori (i pa certifikuar) dhe dy specialiste auditimi (të certifikuar) sipas VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, ku sipas pikës 3, të këtij vendimi thuhet se “Njësia e Auditit të Brendshëm përbehet nga

jo më pak se 3(tre) punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e Njesisë”. Në strukturën e Njesisë së Auditit të Brendshëm mund të punësohen deri 1/3 e punonjësve të pa certifikuar si Auditues te Brendshëm në sektorin publik.

## 1. Struktura e Auditit të brendshëm për vitin 2023

Nr	Periudha	Funksioni	Emëruar	Arsimimi	Vjetërsia	Vjetërsia në Auditim	Certifikimi	Trajnime
1.	A. B.	P/Sektor	19.09.2022	Ek.Finance	24	1		
2.	P. F.	Specialiste Audit	13.01.2017	Ek.Finance	29	8	2010	64 orë / vit
3.	F. D.	Specialiste Audit	01.03.2017	Drejtësi	8	8	2021	64 orë / vit

## 2. Planet Strategjike dhe Vjetore të NJAB, 2023-2025:

**Raportimi:** Planet Strategjike dhe Vjetore të NJAB, janë miratuar nga Titullari i Bashkisë, me shkresën nr. 16776 Prot., datë 10.10.2022. Për vitin 2023, janë planifikuar 9 (nëntë) angazhime auditimi nga të cilat me risk të lartë janë 3 (tre) dhe me risk të mesëm 6 (gjashtë). Planifikimi strategjik është hartuar sipas manualit të auditimit dhe në zbatim të standarteteve të auditimit në planin strategjik, për të gjithë subjektet dhe fushat e veprimtarisë së Vetëqeverisjes Vendore, në zbatim të Strukturës organizative dhe Rregullores së Brendshme të miratuar nga Titullari i Bashkisë. Misionet e auditimit të programuara janë realizuar në masën 100%.

Për veprimtarinë e NJAB janë dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshem Financiar Publik, dhe Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm, Plani Strategjik dhe vjetor për vitet 2023 -2025, si më poshtë:

1. Vlerësimin e nivelit të riskut.
2. Planin strategjik të subjekteve, që synohet të auditohen për vitet (2023-2025).
3. Planin e angazhimeve të parashikuara
4. Planin e nevojave për trajnime
5. Parashikimin e Buxhetit dhe Shpërndarjen e Burimeve të NJAB-së
6. Organigramën e Bashkisë Lezhë.
7. Raportin Shpjegues.

**Karta e AB:** Karta e Auditimit të Njesisë AB është miratuar me Urdherin e Titullarit nr.256, datë 26.04.2022 “Për miratimin e kartës së Auditit të Brendshëm” dhe protokolluar me shkresën nr.19434 prot., datë 07.12.2022.

### **Plani vjetor i punës së Auditit të Brendshëm të miratuar nga Titullari i Bashkisë, për vitin 2023.**

Në Planin Vjetor të punës së Auditit të Brendshëm, të miratuar nga Titullari i Bashkisë, në muajin Tetor 2022, janë planifikuar angazhime auditimi si më poshtë vijon:

Nr	Planifikuar	Realizuar	Niveli i Riskut
1	Drejtoria e Administrimit Aseteve e Kadastrës	po	lartë

2	Drejtoria e MZSH-se	po	lartë
3	Drejtoria e Planifikimit Territorit dhe Zhvillimit Urban	po	lartë
4	Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve	po	mesëm
5	Drejtoria e Emergjencave Civile	po	mesëm
6	Drejtoria e Projekteve Strategjike, Evropes, Migracionit, Diaspores, Komunikimit dhe Transparencës	po	mesëm
7	Njësia Administrative Kallmet	po	mesëm
8	Njësia Administrative Shenkoll	po	mesëm
9	Njësia Administrative Kolsh	po	mesëm

Viti	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT								
	Planifikuar	Realizuar	Nga të realizuarat, sipas llojit						
			Përputhshmeri	Financiar	Kombinuar	Performanc	Tematik	IT	Zbatim Rekomandime
2023	9	9	9						

Duke iu referuar tabelës më sipër rezulton se janë planifikuar 9 (nëntë) auditime dhe janë realizuar 9 (nëntë) auditime. Zbatim i rekomandimeve është realizuar me program më vete për 9 auditimet e lartpërmendura.

### **Auditimet e planifikuara dhe të realizuara për vitin 2023**

1. Drejtoria e Administrimit Aseteve e Kadastrës
2. Drejtoria e MZSH-së
3. Drejtoria e Planifikimit Territorit dhe Zhvillimit Urban.
4. Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve.
5. Drejtoria e Emergjencave Civile.
6. Drejtoria e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës.
7. Njësia Administrative Kallmet.
8. Njësia Administrative Shënkoll.
9. Njësia Administrative Kolsh.

### **Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm për vitin 2023 dhe pasqyrat shoqëruese.**

Njësia e AB ka raportuar në MFE për realizimin e planit vjetor të auditimit, të miratuar nga titullari i Bashkisë, në muajin shkurt të vitit korrent, shkresa nr.1841 Prot., datë 12.02.2024, për angazhimet e auditimit të kryera për vitin paraardhës, ku janë dërguar çdo vit evidencat e realizimit të Planit Vjetor, si më poshtë:

1. Të dhëna për burimet njerëzore të auditimit të brendshëm për vitin e mëparshëm.
2. Realizimi i planit të angazhimeve.
3. Përmbledhëse e gjetjeve me dëm ekonomik nga angazhimet e auditimit.
4. Përmbledhëse e parregullsive të identifikuara sipas sistemeve.
5. Rekomandime të dhëna sipas kategorive.
6. Çështje të dërguara për investigim.
7. Pyetësi i vetëvlerësimit për auditimin e brendshëm.
8. Raporti.

Njësia e AB ka raportuar në M.F.E. për zbatimin e Rekomandimeve, shkresa nr.4237 Prot., datë 08.04.2024, për çdo angazhim auditimi të kryer, sipas planit vjetor dhe sipas Udhëzimit Nr.42, datë 27.10.2020, “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik” dhe standardeve ndërkombëtare të auditimit të pranuar, e angazhuar në misionin e auditimit duke dërguar çdo vit, evidencat si më poshtë:

1. Raportin e zbatimit të rekomandimeve;
2. Rekomandime të dhëna sipas kategorive;
3. Formulari i Verifikimit të Ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve.

Auditimet janë kryer sipas drejtimeve të përcaktuara në programin e auditimit të dërguar për çdo njësi dhe drejtori. Krahas angazhimit të auditimit sipas planit vjetor dhe në zbatim të udhëzimit nr.42, datë 27.10.2020, “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”, NJAB ka realizuar me program auditimi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2023.

Janë dhënë gjithsej 75 (shtatëdhjetë e pesë) rekomandime, sipas prioriteteve dhe sistemeve, për: Përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm nuk janë dhënë rekomandime të përmirësimit të kuadrit ligjor; Rekomandime të karakterit organizativ janë dhënë 50 rekomandime; Rekomandime për arkëtime nuk janë dhënë; Rekomandime të tjera, 25 rekomandime.

Për vitin 2023 zbatimi i rekomandimeve për çdo subjekt, është realizuar me program të miratuar nga Kryetari i Bashkisë, është miratuar udhëri dhe autorizimi për kryerjen e auditimit për zbatimin e rekomandimeve dhe për secilin rast është hartuar P/raporti, Raporti dhe është konfirmuar zbatimi i rekomandimeve.

Rekomandimet e dhëna nga audituesit e brendshëm janë pranuar nga menaxhimi për të gjitha angazhimet e auditimit, janë realizuar në pergjithësi rekomandimet dhe janë në proces zbatimi pjesa tjetër e rekomandimeve të dhëna.

### Rekomandime të pa pranuar nuk ka.

Periudha	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT				SIPAS Raportimit			
	Rekomandime te shprehura ne numër				Rekomandime te shprehura ne vlerë (shpërblim demi)			
	Gjithsej ne numer	Zbatuar	Ne proces	Pa Zbatuar	Gjithsej ne numer	Zbatuar	Ne proces	Pa Zbatuar
Viti 2023	75	31	42	2	0	0	0	0

### Rekomandime të dhëna sipas kategorive për vitin 2023

Nr	Rekomandimet e dhëna sipas prioritetit	REKOMANDIME TË DHËNA NGA AB	REKOMANDIME TË PRANUARA			TOTALI b = b.1 + b.2 + b.3	REKOMANDIME TË PRANUARA
			Rekomandimi zbatuar	Në proces zbatimi	Rekomandime të pazbatuara		

a.	1	(a) = (b) +(c)	(b.1)	(b.2)	(b.3)	(b)	(c)
I	<b>Rekomandime të përmirësimit të sistemeve kontrollit te Breshem</b>						
	<b>SHUMA 1</b>						
II	<b>Rekomandime të përmirësimit të kuadrit ligjor</b>						
	<b>SHUMA 2</b>						
III	<b>Rekomandime të karakterit organizativ</b>						
1	Drejtoria e Administrimit Aseteve e Kadastres	5		5		5	S`ka
2	Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve	5	5			5	S`ka
3	Drejtoria e MZSH-se	8	4	4		8	S`ka
4	Drejtoria e Planifikimit Territorit dhe Zhvillimit Urban	6	3	1	2	6	S`ka
5	Drejtoria e Emergjencave Civile	3	3			3	S`ka
6	Drejtoria e Projekteve Strategjike, Evropes, Migracionit, Diaspores , Komunikimit dhe Transparencës	5	4	1		5	S`ka
7	Njesia Administrative Kallmet	6	2	4		6	S`ka
8	Njesia Administrative Shenkoll	6	4	2		6	S`ka
9	Njesia Administrative Kolsh	6	2	4		6	S`ka
	<b>SHUMA 3</b>	<b>50</b>	<b>28</b>	<b>20</b>	<b>2</b>	<b>50</b>	
IV	<b>Rekomandime për arkëtime</b>						
	<b>SHUMA 4</b>						
V	<b>Rekomandime të tjera</b>						
1	Drejtoria e Administrimit Aseteve e Kadastres	3		3		3	S`ka
2	Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve	4		4		4	S`ka
3	Drejtoria e MZSH-se	4	2	2		4	S`ka

4	Drejtoria e Planifikimit Territorit dhe Zhvillimit Urban	3		3		3	S`ka
5	Drejtoria e Emergjencave Civile	1		1		1	S`ka
6	Drejtoria e Projekteve Strategjike, Evropes, Migracionit, Diaspores , Komunikimit dhe Transparencës	2	1	1		2	S`ka
7	Njesia Administrative Kallmet	3				3	S`ka
8	Njesia Administrative Shenkoll	3		3		3	S`ka
9	Njësia Administrative Kolsh	2		2		2	S`ka
	<b>SHUMA 5</b>	<b>25</b>	<b>3</b>	<b>22</b>	<b>0</b>	<b>25</b>	
	<b>TOTALI (SHUMA I+SHUMA 2+SHUMA 3 +SHUMA 4 +SHUMA 5)</b>	<b>75</b>	<b>31</b>	<b>42</b>	<b>2</b>	<b>75</b>	

**Sektori i AB**, për çdo fillim angazhimi auditimi sipas programit është nxjerrë:

1. Urdhër Shërbimi për auditimin, që është zhvilluar për çdo Njësi Administrative apo Drejtori të Bashkisë Lezhë.
2. Autorizimi për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit për auditim, dërgimi i tyre në Njësitë që do të auditohen.
3. Programi i Auditimit, me llojin e auditimit, Objektivin e Auditimit, Periudhën e auditimit, Afatin e auditimit, Grupi i auditimit që do të kryejë auditimin për çdo Njësi, Drejtimet e auditimit dhe Referencat ligjore.
4. Dokumentacioni i auditimit, për vlersimin e veprimtarisë së subjektit
5. Lista e dokumentave të punës hartuar për çdo njësi, që auditohet dhe dërguar në keto njësi me anë shkresore dhe në rrugë elektronike me e-mail.
6. Pyetesoret, Intervistat etj. sipas angazhimeve të auditimit.
7. Takim Fillestar / Prezantues
8. Takimi Përmbyllës me Subjektin e Audituar
9. Dokumentimi i rezultateve të auditimit. Në përfundim të misionit të auditimit mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, është hartuar Projekt–Raporti me planin e veprimit të sugjeruar, Raporti Final, Memorandumi për Titullarin e Bashkisë, Konfirmimi i Raportit Final dhe Rekomandimeve.
10. Raportet e Auditimit përshkruajnë Gjetjet, japin rekomandimet për përmirsimin e punës dhe sipas perkatesisë i raportohen Kryetarit të Bashkisë, me memorandum.
11. Pyetesori i reagimit pas angazhimit të auditimit.

12. Mbas çdo angazhim auditimi, bashkelidhur projekt-raportit eshte derguar edhe plani veprimit i sugjeruar per çdo njesi te audituar me rekomandimet e dhena.
13. Arshivimi i dosjeve se çdo angazhim auditimi ,me inventar dosje.

Sektori i AB ka dhënë mbështetje në arritjen e objektivave duke:

1. Përgatitur planin strategjik dhe vjetor të auditimit të brendshëm, bazuar në vlerësimin objektiv të riskut si dhe kryerjen e auditimeve në përputhje me planin e miratuar.
2. Vlerësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve dhe të kontrolleve, duke u fokusuar kryesisht në:
  - a. identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga titullari i njësisë publike ose i ngarkuari prej tij
  - b. përputhshmërinë e veprimtarisë me kuadrin rregullator.
  - c. ruajtjen e asetëve.
  - d. besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e informacionit financiar dhe operacional.
  - e. kryerjen e veprimtarisë me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.
  - f. përmbushjen e detyrave dhe arritjen e qëllimeve.

**Konstatim:** -Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura u konstatua se përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, “Manuali i Auditimit të Brendshëm” (MAB). Rezulton se në fillim të vitit janë hartuar deklaratat e pavarësisë, për çdo rast të angazhimit të auditimit janë bërë njoftimet për fillimin e angazhimit të auditimit si dhe autorizimet përkatëse me protokoll të veçantë. Është zhvilluar takimi i hapur prezantues dhe ai përmbyllës, janë hartuar pyetësorët e vlerësimit të përgjithshëm të riskut dhe të fushës që është audituar, si dhe është bërë inventari i dosjeve me dokumentet përkatëse. Hartimi i projekt-raportëve dhe raporteve përfundimtare është bërë sipas strukturës së miratuar në manualin e auditimit.

-Në lidhje me vlerësimin e brendshëm të cilësisë që kryhet nga vetë NjAB konstatohet se nga MFE është kryer Vlerësimi i Cilësisë, Kontrolli i Cilësisë në Bashkinë Lezhë, shkresa me nr.5229 Prot., date 23.03.2022, “Mbi vlerësimin e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm dhe ofrimin e asistencës teknike për zbatimin e një sistemi efektiv të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”. Sipas vlerësimit të cilësisë për Bashkinë Lezhë MFE ka dërguar Projekt-Raportin për kontrollin e cilësisë me shkresën nr.5229/1, datë 26.08.2022.

Në çdo Program të Angazhimit të Auditimit, për Procedurën e vlerësimit të brendshëm të cilësisë është vendosur si pikë e veçante Kontrolli i cilësisë: Ndjekja, mbikqyrja e punës audituese dhe kontrolli i cilësisë, ku kryhet në përputhje me Manualin e A.B., i miratuar me Urdhërin nr.100, datë 25.10.2016 dhe dokumentohet në çdo dosje e për çdo angazhim auditimi, me plotësimin e anekseve “Monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë” dhe “vetëvlerësimin periodik”, duke realizuar sigurimin e brendshëm të cilësisë së veprimtarisë audituese.

- Bashkia Lezhë nuk ka të ngritur Komitetin e Auditimit të Brendshëm të njësisë publike, sipas pikës 3, të Kreut III, të VKM nr.160, datë 02.03.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm të njësisë publike”.

-Nga Njësia e AB eshte miratuar me Urdhërin e Titullarit, Nr.619.datë 07.12.2022, “Për Gjurmët Standarte të Auditit në Njësinë e Auditit të Brendshëm”.

-Njësia e AB, ka hartuar Rregulloren e Brendshme “Për Organizimin, Funksionimin, Punësimin, Detyrat dhe Kompetencat e Njësive të Auditimit të Brendshëm, dhe miratuar nga Kryetari Bashkisë me shkresën nr.19436, datë 07.12.2022.

- Njësia e AB, ka hartuar, regjistrin e riskut për NJAB.
- Njësia e AB, ka hartuar, Hartën e Proceseve të Punës, për Njësinë e Auditit të Brendshëm, shkresa nr.19435 Prot., datë 07.12.2022.
- Kodi Etikës është i miratuar me Urdherin nr.86 datë, 10.12.2015 “Për miratimin e Kodit të Etikës për Audituesit e Brendshëm në Sektorin Publik”;
- Njësia për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve është ngritur që nga viti 2017. Për vitin 2023 kjo njësi është ngritur sipas urdhërit të Kryetarit nr.527, datë 23.09.2022.

*Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi: Përgjegjësi i Sektorit të Njësise të Auditimit të Brendshëm z.A. B..*

## **2. AUDITIM MBI PLANIFIKIMIN, ZBATIMIN DHE MONITORIMIN E PLANIT TË BUXHETIT**

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1083/1, datë 11.09.2024, u auditua *planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 993, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjet vjetore për buxhetin e shtetit të vitit 2023, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit.*

Dokumentacioni që u shqyrtua për auditimin e kësaj pike të programit të auditimit është si vijon:

- PBA 2023-2025;
- Projekt-buxhetin e miratuar për vitin 2023;
- Vendimet e KB “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë” për vitin 2023;
- Vendime të tjera të KB, në lidhje me ndryshimet buxhetore;
- Situacioni i shpenzimeve për vitin 2023 i rakorduar me Degën e Thesarit;
- Situacioni i të ardhurave për vitin 2023 i rakorduar me Degën e Thesarit;
- Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit;
- Raportimet në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë lidhur me detyrimet e prapambetura të Bashkisë;
- Informacion shkresor i përgatitur nga subjekti bazuar në kërkesat e hartuara nga grupi i auditimit.

### **1. Programimi i PBA-së 2023-2025**

Për hartimin e PBA-së 2023-2025 nga Bashkia janë ndjekur dhe zbatuar hapat e më poshtëm:

- Urdhëri i Kryetarit të Bashkisë nr.35, datë 07.01.2022 “Për ngritjen e Grupit Menaxhimit Strategjikë (GMS-së) dhe Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP-ve) për përgatitjen e PBA-së 2023-2025, për Bashkinë Lezhë, i ndryshuar me Urdhërin nr.104, datë 15.03.2022.
- VKB nr.17, datë 28.02.2022 “Për miratimin e raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për dy vitet para vitit buxhetor, vitin buxhetor 2022, dhe tre vitet e ardhshme buxhetore 2023-2025”.
- VKB nr.29, datë 04.04.2022 “Për miratimin e tavaneve të shpenzimeve sipas Programeve Buxhetore për PBA-në 2023-2025 (Faza e parë), të Bashkisë Lezhë dërguar pranë MFE me shkresë nr. 9799, datë 31.05.2022.
- VKB nr.85, datë 28.07.2022 “Për miratimin e tavaneve të shpenzimeve sipas Programeve Buxhetore për PBA-në 2023-2025 (Faza e dytë).



- VKB nr. 120, datë 02.12.2022, "Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe Buxhetin Vjetor 2023", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresë nr. 885/20, datë 14.12.2022.
- Së fundmi është shpërndarë plani i detajuar i buxhetit me shkresën nr. 19643, datë 12.12.2022.

## **2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura**

Për vitin 2023 në Bashkinë Lezhë buxheti është hartuar kryesisht mbi bazën e 20 programeve, përkatësisht: Aparati, Shërbimi Policor, MZSh, Zhvillimi Ekonomik, Shërbimi Bujqësor, Bordi Kullimit, Administrimi i Pyjeve, Menaxhimi i Mbetjeve, Planifikimi Urban Vendor, Shërbimi Publik Vendor, Qendra Kulturore, Arsimi Bazë, Arsimi Mesëm, etj.

Rezulton se buxheti i viteve 2023-2025 është miratuar sipas procedurave dhe kërkesave të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar.

<b>Planifikimi i të ardhurave 2023</b>		<b>Planifikimi i shpenzimeve 2023</b>	
Burimi i të ardhurave	Vlera në 000/ lekë	Emërtimi i zërave	Vlera në 000/ lekë
Të ardhura të planifikuara për vitin 2023	981,193.0	Art. 600 Paga	491,484
Te ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm e të planifikuara për shpenzim për vitin 2023		Art.601 Sigurime shoqërore e shëndetësore	82,075
<b>Total të ardhurat e veta</b>	<b>981,193.0</b>	Art.602 Shpenzime operative	408,674
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar.		Art.604 Transferime korrente brendshme	16,300
Të ardhura të trashëguara nga granti i specifik (transferua specifike 600, 601, 602 etj.).		606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë	51,397.8
Grant i ri i çelur për llogari të vitit 2023	406,808.2	Art.166-651 Huamarrja	8,500
Transfertë specifike e çelur për llogari të vitit 2022	251,748.6	Art.230-231 Investime	570,986
<b>Total të ardhura nga transfertat e buxhetit te shtetit</b>	<b>658,556.8</b>	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	10,351.0
<b>TOTALI TE ARDHURAVE</b>	<b>1,639,749.8</b>	<b>TOTALI SHPENZIMEVE</b>	<b>1,639,749.8</b>

Për vitin 2023 janë bërë gjithsej 47 vendime për ndryshime buxhetore (shtesa dhe pakë-sime), nga këto: Me VKB janë bërë 23 vendime për ndryshime buxhetore; Me vendim të Kryetarit të Bashkisë janë bërë 24 vendime për ndryshime buxhetore, brenda programit.

Për ndryshimet buxhetore të bëra me vendime të Këshillit Bashkiak janë përgatitur projekt-vendimet, të shoqëruara me kërkesat për ndryshim, relacionet përkatëse dhe fish-projektet, të përgatitura nga drejtoritë dhe të miratuara nga Kryetari i Bashkisë. Vendimet e Kryetarit të Bashkisë janë të shoqëruara me kërkesat për ndryshim, relacionet dhe fish-projektet, të përgatitura nga drejtoritë përkatëse dhe të miratuara nga Kryetari i Bashkisë.

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2023				Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2023			
Burimi i të ardhurave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB	Buxheti shtesë/pakësi m,miratuar me VKB	Vlera në 000/lekë	Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB	Buxheti shtesë/pakësim, miratuar me VKB	Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë (në 000/lekë)
	1	2	1+2		3	4	3+4
Të ardhura të planifikuara për vitin 2023	981,193.0		981,193.0	Art. 600 Paga	491,484.0	75,603.5	567,087.5
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm dhe të planifikuara për shpenzim për vitin 2023		42,546.4	42,546.4	Art. 601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	82,075.0	13,269.2	95,344.2
<b>Total të ardhurat e veta</b>	<b>981,193.0</b>	<b>42,546.4</b>	<b>1,023,739.4</b>	Art. 602 Shpenzime operative	408,674.0	52,583.3	461,257.3
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar		67,097.0	67,097.0	Art. 604 Transferime korrente të brendshme	16,300.0	10.0	16,310.0
Të ardhura të trashëguara nga transfertat specifike		49,683.8	49,683.8	Art. 606 Transferime të buxhetit familjar dhe individë	51,397.8	12,933.9	64,331.7
Transferta e pa kushtëzuar e çelur për llogari të vitit 2023	406,808.2	67,121.1	473,929.3	Art.166-651 Huamarrja	8,500.0	0.0	8,500.0
Transferta specifike e çelur për llogari të vitit 2023	251,748.6	9,629.9	261,378.5	Art. 230-231 Investime	570,968	82,562.3	653,530.3
<b>Total të ardhurat nga transfertat e buxhetit të shtetit</b>	<b>658,556.8</b>	<b>193,531.8</b>	<b>852,088.6</b>	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	10,351.0	-884.0	9,467.0
<b>TOTALI TË ARDHURAVE</b>	<b>1,639,749.8</b>	<b>236,078.2</b>	<b>1,875,828.0</b>	<b>TOTALI SHPENZIMEVE</b>	<b>1,639,749.8</b>	<b>236,078.2</b>	<b>1,875,828.0</b>

### Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2023

Për vitin 2023 planifikimi total i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën **3,203,717** mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën **2,436,432** mijë lekë, ose në masën **76.1%**.

Nga këto janë realizuar nga të ardhurat e veta 1,332,619 mijë lekë dhe vlera e mbuluar nga FZHR dhe granti është **1,103,813** mijë lekë. Nga këto, fondi i pagave (llogaria 600) është realizuar me 88%, sigurime shoqërore dhe shëndetësore (llogaria 601) është realizuar me 87%, shpenzimet operative (llogaria 602) është realizuar me 67.5%, transfertat korrente të brendshme (llogaria 604) është realizuar me 50%, dhe fondi i investimeve (llogaria 231) është realizuar me 72.5%. Realizimi i buxhetit sipas zërave paraqitet në mënyrë më të detajuar në tabelën në vijim.

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Lezhë, për vitin 2023, në mijë lekë						
Nr.	Përshkrimi i shpenzimeve	Plani 2023	Fakti 2023	Realizimi %	Vlera mbuluar nga të ardhurat	Vlera mbuluar nga FZHR dhe granti
1	Artikulli - 600 Paga	581,352.5	512,194.2	88.1	498,194.8	13,999.4
2	Artikulli - 601 Sig. shoqërore & shend	97,044.2	84,614.2	87.2	83,080.1	1,534.1
3	Artikulli - 602 Shpenzime operative	478,427.0	323,172.7	67.5	321,859.4	1,313.3
4	Artikulli - 604 Transferta korrente te brendshme	32,509.4	16,054.8	49.4	16,054.8	0.0
5	Artikulli - 606 Transferime te buxhetet familjare (Ndihma ek. dhe PAK)	893,576.4	694,676.7	77.7	46,719.8	647,956.9
6	Artikulli 166-651 Huamarrja Afatgjatë	8,500.0	8,359.7	98.3	8,359.7	0.0

7	Artikulli 609 Fondi Rezervë dhe Fondi i Kontigjencës	10,351.0	884.0	8.5	884.0	0.0
8	Artikulli - 230 Projekte	3,064.7	0.0	0.0	0.0	0.0
9	Artikulli - 231 Investime	1,098,892.0	796,475.9	72.5	357,466.6	439,009.3
	<b>TOTAL viti 2023</b>	<b>3,203,717.2</b>	<b>2,436,432.2</b>	<b>76.1</b>	<b>1,332,619.2</b>	<b>1,103,813.0</b>

Nga bashkia ndarja e plan buxhetit dhe detajimi në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Në këto programe buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të granteve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së pakushtëzuar sektoriale, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuara nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve. Gjatë këtij viti, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar dhe rialokimeve të kryera nga vetë bashkia, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, sipas përcaktimit të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 47<sup>1</sup>, ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 44<sup>2</sup>, Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisë të vetëqeverisjes vendore" shtojca 4, pika c.

### **3. Saktësia e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit**

Për vitin 2023 planifikimi total i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën **3,203,717** mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën **2,436,432** mijë lekë, ose në masën **76.1%**.

Nga Drejtoria e Financës është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt rakordimet përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me VKB, ose të diktura nga grandet e deleguara nga pushteti qendror. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi plan buxhetin dhe detajimin në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se në të gjitha rastet është respektuar disiplina buxhetore. Nga auditimi rezulton se ndër zërat që paraqiten me mos realizim janë:

- shpenzimet operative, realizuar në masën 67.5%, ose 139,398 mijë lekë më pak se plani, për shkak të mungesës së likujditeteve si pasojë e mos realizimit të të ardhurave, pasi këto shpenzime mbulohen kryesisht nga të ardhurat e veta;
- transfertat korrente të brendshme realizuar në masën 50% dhe fondi rezervë dhe i kontigjencës realizuar në masën 8.5%, si pasojë e mos përdorimit të plotë të fondit akorduar për emergjencat civile.

<sup>1</sup> Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore bën një analizë të plotë të zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor të çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, edhe propozimet përkatëse për ndryshimin e vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, që ka miratuar buxhetin e vitit. Procedura e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve të vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore është e njëjtë me atë të vendimit për miratimin e buxhetit vjetor.

<sup>2</sup> Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim të këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport i paraqitet këshillit jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.

Në zbatim të detyrimeve ligjore për monitorimin e zbatimit të buxhetit, ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 44 dhe ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48, Bashkia Lezhë ka përgatitur:

1. Raportin e monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e vitit 2023, miratuar me VKB nr. 18, datë 27.07.2023, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresë nr. 595/10, datë 03.08.2023 dhe dërguar në MFE me shkresë nr. 6016 prot., datë 31.05.2023;
2. Raportin e monitorimit të buxhetit për 8-mujorin e vitit 2023 miratuar me VKB nr. 50, datë 02.11.2023, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresë nr. 901/10, datë 07.11.2023 dhe dërguar në MFE me shkresë nr. 15031/1 prot., datë 27.09.2023;
3. Raportin e monitorimit të buxhetit për 12-mujorin e vitit 2023 miratuar me VKB nr. 22, datë 29.02.2024, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresë nr. 216/26, datë 11.03.2024 dhe dërguar në MFE me shkresë nr. 1849 prot., datë 12.02.2024.

#### 4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve

##### Detyrimet e prapambetura për investimet

Emërtimi i i Objektivit të Prokurimit	Emërtimi i Subjektit	Data e lidhjes së kontratës	Nr. fatur	Data e Fatutës	Vlera e kredisë 31.12.2022	Shtesat gjate 2023	Shlyerje gjatë 2023	Gjendja 31.12.2023
Rikualifikim Urban Shetitorja ËillsonRikualifikim Urban Shetitorja Ëillson	F. shpk	02.06.2015	3	02.06.2015	17,495,807	0	0	17,495,807
Sistemim, asfaltim rruget Lezhe	U. shpk	21.10.2022	29	02.03.2023		94,445,430	90,030,736	4,414,264
Kolaudim objekti:Rehabilitim muri mbajtes	N.M.	06.03.2023	3	23.03.2023		113,940		113,940
Mbikqyrje rruget i rrugve rurale	T.	15.10.2020	11	07.04.2023		112,320		112,320
Rehabilitimi I shetitores	M.	04.01.2023	16	04.05.2023		26,183,871		26,183,871
Ndertim trotuari ne lagjen Xhenio	E.	30.11.2022	5	23.05.223		4,986,198		4,986,198
Mbik/Ndertim Trotuari te Ri ne Lagjen "Xhenio"	R. SHPK	23.12.2022	39	29.05.2023		177,964		177,964
Sistemim, asfaltim rruget Lezhe	U. shpk	21.10.2022	51	08.05.2023		34,456,247		34,456,247
Mirembajtje asfaltim i rrugve rurale	P. Group	16.07.2020	6805	20.06.2023		10,590		10,590
Mirembajtje asfaltim i rrugve rurale	P. Group	16.07.2020	6806	20.06.2023		5,727,564		5,727,564
Rehabilitimi I shetitores	M.	04.01.2023	43	21.07.2023		14,560,840		14,560,840
Mbik-Infrastruktura e plazhit Tale	E. G	21.02.2023	45	04.07.2023		960,210		960,210
Mbik-Infrastruktura e plazhit Tale	E. G	21.02.2023	46	04.07.2023		501,312		501,312
Mbikqyrje rruget i rrugve rurale	T.	15.10.2020	28	19.08.2023		36,845		36,845
Sistemim, asfaltim rruget Lezhe	U. shpk	21.10.2022	88	05.10.2023		7,720,513		7,720,513
Mbikqyrje:Sis asfaltim I rrugeve rurale, urbane	M.	16.11.2022	59	17.10.2023		274,205		274,205

Mbikqyrje:Sist asfaltim I rrugeve rurale, urbane	M.	16.11.2022	62	26.10.2023		865,474		865,474
Sistemim blloku Beselidhja	N. shpk	13.08.2019		Gjate 2019	(16,601,894)			(16,601,894)
Nd.rruga L.Gurakuqi	A. B. shpk	03.06.2019	14	31.07.2019	2,346,428		4,663,428	(2,316,570)
<b>Totali i detyrimit</b>					<b>3,240,341</b>	<b>191,133,523</b>	<b>94,694,164</b>	<b>99,679,700</b>

### Detyrimet e prapambetura për mallra e shërbime

Emërtimi i i Objektivit	Emërtimi i Subjektit	Data e lidhjes së kontratës	Nr. faturës	Data e Faturës	Vlera e kredisë 31.12.2022	Shtesat gjate 2023	Shlyerjet gjatë 2023	Gjendja 31.12. 2023
Sh.a UK Lezhë detyrime ujë i pijshëm	Ujesjelles kanalizime	-	223	2014-2019	28,561,916			28,561,916
Sherbim DDD	M. shpk	01.09.2021	594	25.09.2021	209,758			209,758
Oponence teknike	Instituti ndertimit	01.11.2022	1157	08.11.2022		100,000		100,000
Oponence teknike	Instituti ndertimit	31.10.2022	1158	08.11.2022		161,597		161,597
Pako ushqimore	L. group		57	29.12.2022		100,000		100,000
Kontroll teknik	DRSHTR		4075	30.12.2022		2,100		2,100
Kontroll teknik	DRSHTR		4086	30.12.2022		1,000		1,000
Leje qarkullimi	DPSHTRR		1809	23.02.2023		2,700		2,700
Leje qarkullimi	DPSHTRR		1806	23.02.2023		2,100		2,100
Siguracion mjete	S.	07.02.2023	20232896	13.02.2023		28,124		28,124
Siguracion mjete	S.	07.02.2023	20232895	13.02.2023		28,124		28,124
Blerje fidanesh	A. G.	03.02.2023	22	10.02.2023		286,560		286,560
Aktivitet (Salle konferencash )	R.		62	05.04.2023		45,684		45,684
Akt ekspertiza e pallateve	Instituti Ndertimit	06.10.2022	399	10.05.2023		4,800,000		4,800,000
Akt ekspertiza e banesave individuale	Instituti Ndertimit	06.10.2022	400	10.05.2023		124,665		124,665
Blerje e materialeve per mirembajtjen e rrugeve,	S. Shpk	05.04.2023	65	23.06.2023		528,440		528,440
Blerje e materialeve per mirembajtjen e rrugeve,	S. Shpk	05.04.2023	66	26.06.2023		2,831,280		2,831,280
Blerje e materialeve per mirembajtjen e rrugeve,	S. Shpk	05.04.2023	69	29.06.2023		927,360		927,360
Mirembajtja auto per bashkise	E. P.	12.04.2023	14	27.06.2023		38,880		38,880
Mirembajtja auto per bashkise	E. P.	12.04.2023	13	27.06.2023		159,480		159,480
Mirembajtja auto per bashkise	E.P.	12.04.2023	12	27.06.2023		163,440		163,440
Mirembajtja auto per bashkise	E. P.	12.04.2023	16	31.07.2023		245,640		245,640
Mirembajtja auto per bashkise	E.P.	12.04.2023	17	31.07.2023		125,520		125,520
Mirembajtja auto per bashkise	E. P.	12.04.2023	18	31.07.2023		176,400		176,400
Mirembajtja auto per bashkise	E.P.	12.04.2023	19	31.07.2023		154,920		154,920
Mirembajtja auto per bashkise	E.P.	12.04.2023	20	31.07.2023		37,920		37,920
Mirembajtja auto per bashkise	E. P.	12.04.2023	22	31.07.2023		537,720		537,720

Blerje e materialeve per mirembajtjen e rrugeve,	S. Shpk	05.04.2023	86	13.07.2023		567,000		567,000
Blerje e materialeve per mirembajtjen e rrugeve,	S. Shpk	05.04.2023	87	19.07.2023		1,654,080		1,654,080
Blerje e materialeve per mirembajtjen e rrugeve,	S. Shpk	05.04.2023	93	02.08.2023		132,000		132,000
Blerje e materialeve per mirembajtjen e rrugeve,	S. Shpk	05.04.2023	94	02.08.2023		330,000		330,000
Blerje e materialeve per mirembajtjen e rrugeve,	S. Shpk	05.04.2023	95	03.08.2023		1,462,320		1,462,320
Blerje e materialeve per mirembajtjen e rrugeve,	S. Shpk	05.04.2023	96	04.08.2023		1,801,500		1,801,500
Blerje e materialeve per mirembajtjen e rrugeve,	S. Shpk	05.04.2023	99	14.08.2023		3,504,300		3,504,300
Blerje e materialeve per mirembajtjen e rrugeve,	S. Shpk	05.04.2023	102	15.08.2023		3,080,700		3,080,700
Blerje e materialeve per mirembajtjen e rrugeve,	S. Shpk	05.04.2023	103	18.08.2023		1,448,400		1,448,400
Blerje e materialeve per mirembajtjen e rrugeve,	S. Shpk	05.04.2023	104	24.08.2023		252,000		252,000
Blerje e materialeve per mirembajtjen e rrugeve,	S. Shpk	05.04.2023	105	25.08.2023		363,600		363,600
Materiale per godinat arsimore	S. Shpk	05.04.2023	120	26.09.2023		6,013,374		6,013,374
Mirembajtja auto per bashkise	E.P.	12.04.2023	25	31.10.2023		361,800		361,800
Vendime gjyqesore	S. H.	Vend gjyk NR.59		24.01.2013		4,271,250		4,271,250
Furnizim me vaj	L. 80	F.Hyrja 25	69	26.05.2021	-25000			(25,000)
<b>Totali i detyrimit</b>						<b>28,746,674</b>	<b>36,851,978</b>	<b>65,598,652</b>

**Nga auditimi konstatohet se**, detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2022 kanë qenë në vlerën totale prej 36,382,315 lekë, gjatë vitit 2023 janë krijuar detyrime në vlerën 227,985,501 lekë dhe janë shlyer detyrime në vlerën 99,089,464 lekë, duke rezultuar në fund të vitit 2023 një vlerë e detyrimeve të prapambetura prej 165,278,352 lekë, të cilat përbëhen nga detyrime për investimet në vlerën 99,679,700 lekë dhe detyrime për mallra e shërbime në vlerën 65,598,652 lekë. Konstatohet se vlera e detyrimeve të prapambetura është rritur pothuajse 4 herë më tepër se në 2022, të cilat kanë ardhur si pasojë e mos likuidimit të investimeve, si dhe përdorimit të fondeve për likuidimin e vendimeve gjyqësore për largimet nga puna, të lindura në vitin 2022. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore", neni 34, pika 1, "Jo më vonë se data 31 janar, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore paraqet për shqyrtim e miratim në këshill raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për: a) dy vitet para vitit buxhetor; b) vitin buxhetor; c) tre vitet e ardhshme buxhetore...", neni 40, pika 3, "Projektbuxheti vjetor përfshin...informacion mbi gjendjen/stokun e borxhit të njësisë së vetëqeverisjes vendore...detyrimet kontingjente dhe mundësinë e shfaqjes së tyre si detyrime në vitin buxhetor pasardhës". Udhëzim i MFE nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pika 101, "Në miratimin e fondeve sipas programeve dhe zërave të shpenzimeve, më parë do të mbulohen detyrimet e papaguara nga viti i mëparshëm dhe pastaj fondet për të financuar veprimtarinë e vitit në vazhdim".

Vështirësia Financiare e Bashkisë Lezhë

Në UMFE nr.26, datë 27.03.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”, trajtohet shkalla e vështirësisë financiare dhe menaxhimi i këtyre vështirësive.

Gjithashtu në ligjin nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, datë 27.04.2017, kreu XI vështirësitë financiare dhe masat për zgjidhjen e tyre, neni 55 Probleme Financiare, pika 1.

Për Bashkinë Lezhë, totali i shpenzimeve të miratuara nga të ardhurat e veta me VKB për vitin 2023 ka vlerën 1,332,619 mijë lekë, ndërsa stoku i detyrimeve të prapambetura më 31.12.2023, ka vlerën 165,278 mijë lekë. Raporti i këtyre treguesve, pra raporti i stokut të detyrimeve të prapambetura me shpenzimeve totale të miratuara, ka vlerën 12%, shifër që e klasifikon Bashkinë Lezhë në njësi të qeverisjes vendore pa probleme financiare, paraqitur si në tabelën mëposhtë:

N.R	Emërtimi	Stokun vlerë	Totali i shpenzimeve faktike për NJQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale faktike të NJQV-së
<b>I</b>	<b>Borxhe (a+b)</b>	<b>0</b>		
<b>a</b>	<b>Hua afatgjatë</b>	<b>0</b>		
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
<b>b</b>	<b>Hua afatshkurtër</b>	<b>0</b>		
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kreditë furnitorëve			
<b>II</b>	<b>Detyrime (a+b+c)</b>	<b>165,278,352</b>		<b>12%</b>
<b>a</b>	<b>Shpenzime korrente</b>			
a,1	Mallra dhe shërbime	61,327,402		
a,2	Paga dhe sigurime			
a,3	Të tjera			
<b>b</b>	<b>Shpenzime kapitale</b>	<b>99,679,700</b>		
b,1	Institucione buxhetore			
b,2	Subjekte private			
<b>c</b>	<b>Vendime gjyqësore</b>	<b>4,271,250</b>		
c,1	Marrëdhënie pune			
c,2	Mallra dhe shërbime	4,271,250		
c,3	Investime			
c,4	Të tjera			
<b>III</b>	<b>Totali (I+II)</b>	<b>165,278,352</b>	<b>1,332,619,225</b>	<b>12%</b>

Megjithatë, nga auditimi rezulton se Bashkia Lezhë ka raportuar si shpenzime vjetore faktike vlerën prej 1,875,828 mijë lekë që në fakt është vlera e shpenzimeve të planifikuara dhe jo e atyre

faktike. Sipas raportimit të Bashkisë Lezhë në MFE me anë të e-mail dhe po kështu nëpërmjet raportimit të buxhetit faktik me shkresë nr. 1849, datë 12.04.2024, me këto të dhëna rezulton se vështirësia financiare është 8.81%. Pavarësisht përlllogaritjes së vështirësisë financiare mbi raportin e shpenzimeve plan dhe jo atyre fakt, gjithsesi Bashkia Lezhë klasifikohet në Bashki pa vështirësi financiare. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me paragrafin 59 të Udhëzimit nr. 35, datë 29.12.2023, “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për Njësitë e Vetëqeverises Vendore”.

*Për sa më lart është mbajtur Akt konstatimi nr. 5 me Z. P. N., Znj. B. V. dhe dhe Z. Xh. H..*

### **BURIMI I KRIJIMIT TË TË ARDHURAVE DHE MBLEDHJA E TYRE**

Në zbatim të Programit të Auditimit cituar më sipër pika 2, nënpika 2.6, u auditua *burimi i krijimit të të ardhurave dhe vlerësimi i mbledhjes së tyre bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.*

Dokumentacioni që u analizua për të vlerësuar administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore është si vijon:

- Vendimet e Këshillit Bashkiak Lezhë për miratimin e paketave fiskale të vitit 2023;
- Pasqyrat financiare në lidhje me arkëtimet, kontabilizimin dhe pasqyrimin e të ardhurave nga subjektet dhe familjarët, lidhur me taksat dhe tarifave vendore;
- Dokumentacioni i Sektori i Tatim Taksave, në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave dhe dokumentacionit të tatim-paguesve;
- Kontrata, procesverbale dhe relacione në lidhje me të ardhurat;
- Regjistrat dhe mbajtja e debitorëve për bizneset, për taksat dhe tarifave vendore;
- Realizimi faktik i të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Sektori i Tatim Taksave.

### **Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve**

Për vitin 2023 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Lezhë është miratuar me VKB-në nr. 112, datë 31.10.2022, “Për miratimin e nivelit të taksave, tarifave vendore për shërbimet publike dhe ato administrative, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penaliteteve ndaj kundravajtësve”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Lezhë me shkresë nr. 799/4 prot., datë 07.11.2022.

Nr.	EMËRTIMI	PLAN	FAKT	%
<b>I</b>	<b>TAKSAT VENDORE</b>	<b>604,550</b>	<b>346,712</b>	<b>57%</b>
<b>I/a</b>	<b>Të ardhura nga Taksat</b>	<b>560,000</b>	<b>260,587</b>	<b>47%</b>
1	Taksa mbi pasuritë	160,000	99,696	62%
1.1	Taksa mbi ndërtesën	106,262	79,494	75%
1.2	Taksa mbi tokën bujqësore	25,459	5,388	21%
1.3	Taksa mbi truallin	28,279	14,814	52%
2	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin		901	-
3	Taksa e ndikimit infrastrukturës nga ndërt. e reja	335,000	128,585	38%
4	Taksa e tabelës dhe reklamës	10,000	1,736	17%



5	Taksa e fjetjes në hotele	50,000	27,370	55%
6	Taksa të tjera të përkohshme	5,000	2,299	46%
6.1	Për infrastrukturën nëntokësore	5,000	1,603	32%
6.2	Për infrastrukturën në arsim		696	-
<b>I/b</b>	<b>Taksat e ndara</b>	<b>44,550</b>	<b>86,125</b>	<b>193%</b>
1	Taksa e kalimit drejtës pronësisë P.palujtshme	9,000	10,207	113%
2	Taksa e regjistrimit të automjeteve	35,000	47,590	136%
3	Taksa e rentës minerale	550	423	77%
4	Tatimi mbi të ardhurat personale		27,905	-
5	Taksa të tjera			
<b>II</b>	<b>Të ardhura jotatimore</b>	<b>376,643</b>	<b>247,024</b>	<b>66%</b>
<b>II/a</b>	<b>Të ardhura nga tarifat vendore</b>	<b>322,053</b>	<b>234,445</b>	<b>73%</b>
1	Tarifa e pastrimit dhe largimit mbetjeve	88,000	104,942	119%
2	Tarifë ndriçimi publik	34,700	18,351	53%
3	Tarifë gjelbërimi	33,400	15,138	45%
4	Tarifë shërbimi veterinar			-
5	Tarifa të tjera (licencë, leje, autorizime, etj.)	11,451	3,042	27%
6	Tarifë parkimi	10,255	7,622	74%
7	Tarifë për kulturën	1,355	1,506	111%
8	Tarifë për hapësirat publike	100,000	51,903	52%
9	Të ardhura nga tarifat e urbanistikës	12,000	16,704	139%
10	Tarifë për shërbimet e MZSh	1,500	1,380	92%
11	Tarifë leje transporti	947	1,304	138%
12	të ardhura nga tarifa e lëndëve drusore	529	25	5%
13	Tarifë për shërbimet administrative			-
14	Tarifë e shërbimit të ujit dhe kullimit			-
15	Pagesat nga çerdhet	3,516	2,139	61%
16	Pagesat nga kopshtet	10,500	7,538	72%
17	Pagesa nxënësve të konviktit Shk. M. Profesionale		20	-
18	Tarifa të tjera	13,900	2,831	20%
<b>II/b</b>	<b>Të ardhura nga shitja e pronës, dhënia me qira</b>	<b>8,385</b>	<b>4,549</b>	<b>54%</b>
1	Shitje ndërtese banimi			-
2	Shitje troje			-
3	Shitje prona të tjera			-
4	Qira mbi trojet		4,546	-
5	Qira tokë bujqësore	6,943	3	0%
6	Qira mbi ndërtesat, pajisjet, etj.	1,442		0%
<b>II/c</b>	<b>Të ardhura të tjera</b>	<b>46,205</b>	<b>8,030</b>	<b>17%</b>
1	Nga dhuratat dhe sponsorizimet etj.	39,000	360	1%
2	Nga gjobat	7,080	6,543	92%
3	Të ardhura të tjera (debitorë, ankande, etj.)	125	1,127	902%
	<b>TOTALI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË</b>	<b>981,193</b>	<b>593,736</b>	<b>61%</b>

Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën më sipër për periudhën nën auditim realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Lezhë për vitin 2023 është në masën **63%** nga 934,988 mijë lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 585,706 mijë lekë (pa përfshirë të ardhura të tjera – sponsorizimet, gjobat, etj.).

**Nga auditimi u konstatua se:** Për vitin 2023 në Bashkinë Lezhë niveli i realizimit të të ardhurave është 63%, duke sjellë diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit të bashkisë për sa i takon pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve. Niveli i ulët i realizimit të të ardhurave ka ndikuar në mosrealizimin e shpenzimeve të planifikuara me burim financimi të ardhurat e veta të bashkisë dhe marrjen e angazhimeve buxhetore pa patur burime financimi reale. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor dhe rregullator për hartimin dhe zbatimin e buxhetit, përkatësisht:

- Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;
- Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, 35, 54;
- Për vitin 2023 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Lezhë është miratuar me VKB-në nr. 112, datë 31.10.2022, “Për miratimin e nivelit të taksave, tarifave vendore për shërbimet publike dhe ato administrative, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penalteteve ndaj kundravajtësve”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Lezhë me shkresë nr. 799/4 prot., datë 07.11.2022, pika A dhe B me të gjithë nënpikat për taksat dhe tarifave.

### **Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet**

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet llogaritet në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3.c<sup>3</sup> dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlera vetë zbatueshme për legalizim”, pika 5<sup>4</sup>.

Në Bashkinë Lezhë struktura që administron dokumentacionin dhe përlllogarit vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë referuar kërkesave ligjore të sipër cituara për subjektet dhe qytetarët që pajisen me certifikatën e pronësisë është Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban.

Në fund të vitit 2022 (progresive)	Nr.	Vlerë
Taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale	375	6,141,053.00
Krijuar brenda vitit 2023	Nr.	Vlerë
Taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale	175	6,078,656.00
Në fund të vitit 2023 (progresive)	Nr.	Vlerë
Taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale	<b>550</b>	<b>12,219,709.00</b>

<sup>3</sup>Ligji nr. 95.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesane ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3.c “për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesi”.

<sup>4</sup>VKM nr. 860, datë 10.12.2014, pika 5: “Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Për zbatimin e kësaj pike, drejtoritë e ALUIZNI-t, të vënë në dispozicion të njësitë të qeverisjes vendore, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi”.

**Nga auditimi u konstatua se** lidhur me detyrimet që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë rezultojnë se për vitin 2023 janë legalizuar 175 objekte me vlerë 6,078,656 lekë, të cilët nuk kanë paguar detyrimin, si dhe nga vitet e mëparshme janë 375 debitorë në vlerë totale **6,141,053 lekë, në total 550 debitorë në vlerë 12,219,709 lekë.**

Nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet vlera totale prej 12,219,709 lekë, është njohur dhe dërguar pranë degës së financës për kontabilizim vetëm detyrime për arkëtim në vlerën **5,866,613 lekë** e vitit 2023, duke bërë që diferenca prej **6,353,096 lekë** e pa kontabilizuar të konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Lezhë.

### **Administrimi i taksave dhe tarifave vendore**

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj, në Bashkinë Lezhë kryhet në programin Excel nga 01.01.2023-31.07.2023 dhe nga 01.08.2023-31.12.2023 me sitemin Eterna. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore gjithashtu kryen edhe regjistrim manual të të dhënave (regjistra fizik) dhe të çdo informacioni lidhur me subjektet apo familjet objekt i taksave dhe tarifave vendore.

<b>Nr.</b>	<b>Lloji Biznesit</b>	<b>Gjendja në fillim</b>	<b>Regjistrime të reja</b>	<b>Mbyllur aktiviteti</b>	<b>Gjendja në fund të Vitit</b>
1	Biznesi Vogël	4 558	400	70	4 888
2	Biznesi Madh	972	18	0	990
	Gjithsej	5 530	481	70	<b>5 878</b>

### **Menaxhimi i borxhit**

Në realizimin në nivel të ulët të të ardhurave kanë ndikuar **niveli i lartë e debitorëve**. Në bazë të përpunimit të të dhënave të regjistrimit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Lezhë rezultoi se, ka nivel të lartë **debitorësh** në numër dhe në vlerë, duke përfshirë biznesin, institucionet dhe pronarët (për taksën e ndërtesës, tabelës, trualli, zënie hapësire publike, etj.), i cili nga viti në vit ka ardhur duke u rritur, kështu në fund të **vitit 2022** vlera borxhit është **246,341,820 lekë** dhe në fund të **vitit 2023** vlera e borxhit është **278,035,252 lekë**. Informacion më i detajuar lidhur me debitorët progresivë paraqitet në tabelën mëposhtë.

Nr	Subjekti	Debi Progressive 31.12.2022 (principal + kamatvonesë, e cila ka rezultuar e pa likuiduar)	Likuiduar gjatë vitit 2023	Debi e krijuar gjatë vitit 2023							Total krijuar në 2023	Kamat-vonesë e aplikuar	Debi progressive 31.12.2023 = 278,035,252 lekë	
				Principal, që ndahet në									Principal	Kamat-vonesë
				Taksë ndërtesë	Taksë Trualli	Taksë Tabele	Taksë fjetjes hotel	Taksë e Tarifë Shërbimi Publik	Hapësire Publike	Të tjera				
1	BM	141,104,497	131,099,253	26,617,698	9,755,008	1,279,850	20,843,800	58,305,267	21,628,850	2,265,000	140,695,473		140,695,473	10,114,264
2	BV	93,632,023	87,239,582	21,219,770	4,582,781	539,970	12,240,806	41,596,596	21,752,650	770,000	102,702,573	354,590	103,057,163	14,263,705
3	Institucione	4,465,076	2,068,976					1,369,816			1,369,816		1,369,816	
4	Pronarë	7,140,224		5,840,004	1,130,891						6,970,895	7,896	6,978,791	1,556,040
	<b>Totali</b>	<b>246,341,820</b>	<b>220,407,811</b>	<b>53,677,472</b>	<b>15,468,680</b>	<b>1,819,820</b>	<b>33,084,606</b>	<b>101,271,679</b>	<b>43,381,500</b>	<b>3,035,000</b>	<b>251,738,757</b>	<b>362,486</b>	<b>252,101,243</b>	<b>25,934,009</b>

Referuar tabelës së mësipërme, vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në fund të vitit 2022 është në vlerën **246,341,820 lekë**, vlera e borxhit e krijuar bashkë me kamatëvonesat **gjatë vitit 2023** është **252,101,243 lekë** ndërkohë që janë bërë pagesa në vlerën 220,407,811 lekë dhe gjendja e debitorëve në mënyrë progresive **në fund të vitit 2023** është në vlerën **278,035,252 lekë, që përbën detyrim për arkëtim**, duke qenë se e gjithë vlera e mësipërme është njohur dhe kontabilizuar.

### **Taksat dhe tarifat familjare**

Në Bashkinë Lezhë aktualisht familjet ngarkohen me detyrime për tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka të dhëna lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin për të paguar tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës, nuk ka të dhëna lidhur me nivelet e pritshmërisë së tyre si dhe nuk ka të dhëna se sa është numri i familjeve, që janë debitorë ndaj bashkisë.

Bashkia Lezhë, për mbledhjen e detyrimeve për Taksën e ndërtesës dhe tarifë pastrimi –gjelbërim-ndriçimi për abonentët familjarë e realizon nëpërmjet agjentit tatimor që në rastin konkret është UK Sha Lezhë në bazë të VKB nr. 112, datë 31.10.2022, “Për miratimin e nivelit të taksave, tarifave vendore për shërbimet publike dhe ato administrative, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penalteteve ndaj kundravajtësve”, pika A.2.a.7, germa b. Nga Bashkia Lezhë është lidhur akt-marrëveshje me nr. 6494 prot., datë 16.07.2018 Agjentin tatimor UK sha. Në lidhje me detyrimet e abonentëve familjarë, u konstatua se Bashkia Lezhë nuk ka regjistër të familjeve me të dhënat sa është numri i familjeve gjithsej për sipërfaqet e banimit, që ka secila familje dhe se kujt viteve i përket, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe sa familje janë të përjashtuar nga pagesa e këtyre taksave, nuk plotësohet njoftim detyrimi për familjet që nuk kanë kontratë me UK sha Lezhë për taksën e ndërtesës, tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit.

Të dhënat për abonentët familjarë nga njësitë administrative dhe UK Lezhë janë paraqitur arkëtimet e detyrimeve në aneksin nr. II.6.1.

### **Taksa mbi tokën bujqësore**

Taksa mbi tokën bujqësore llogaritet në bazë të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23<sup>5</sup>.

Sipas Aneksit 1 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, Bashkia Lezhë për tokën bujqësore është si në tabelën mëposhtme:

<b>Kategoria e tokës bujqësore</b>	<b>Niveli i taksës së tokës bujqësore sipas VKB (lekë/ha/vit)</b>
I	3,920
II	3,430
III	2,940
IV	2,520
V	2,100
VI	1,680
VII-X	1,260

**Nga auditimi u konstatua se,** në Bashkinë Lezhë familjet nuk ngarkohen për pagesën e taksës së tokës bujqësore si dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka asnjë informacion lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin të paguajnë këtë taksë dhe sipërfaqes së tokës bujqësore që familjet zotërojnë me AMTP mbi të cilën llogaritet dhe planifikohen të ardhurat nga taksa e tokës bujqësore. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 pika 1, Aneksi 1.

Të vetmet pagesa që bëhen për taksën e tokës bujqësore janë rastet, kur fermerët paraqiten në bashki apo NJA në mënyrë vullnetare për të paguar taksat dhe tarifave vendore apo për të marrë shërbime dhe nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ju mbahet edhe taksa e tokës, kur bashkia ka të dhëna.

Nga NJA nuk disponohen regjistrat e saktë të tokës me të dhënat e sipërfaqeve dhe cilësisë së tokave (kategorizimi), si dhe marrëdhëniet juridike më të, pra statusi i pronësisë për të gjitha familjet fermere, gjë që është e domosdoshme për të patur të dhëna të sakta për bazën e taksueshme dhe për një planifikim të taksës së tokës mbi baza reale. Nga specialistët e tatimeve në NJA nuk ngarkoheshin familjet fermerë me taksën e tokës sipas kategorisë dhe nivelin e taksës përkatëse të përcaktuar në paketën fiskale.

### **Masat e marra për uljen e borxhit**

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Lezhë është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara.<sup>6</sup> Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Sektori i Mbledhjes dhe Menaxhimit të Borxhit lidhur me zbatimin e hapave që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, janë njoftuar bizneset debitorë sipas Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 4 pika 1 dhe 2, Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 89, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 24 datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore të

<sup>5</sup>Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23, pika 1, aneksi 1.

<sup>6</sup>Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 89, 90, 91, 93.

Republikës së Shqipërisë”, pika 89, i ndryshuar. Pas kalimit të afatit për pagimin në mënyrë vullnetare të këtyre detyrimeve, nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Sektori i Mbledhjes dhe Menaxhimit të Borxhit janë dërguar në bankat përkatëse Urdhër bllokimi i llogarive bankare:

- Nr. 355 – 360 prot., datë 12.01.2023, për 6 subjekte;
- Nr. 459 prot., datë 16.01.2023, për 1 subjekte;
- Nr. 5664 – 5702 prot., datë 29.05.2023, për 38 subjekte;
- Nr. 5986 – 6004 prot., datë 31.05.2023, për 19 subjekte;
- Nr. 7399 - 7404 prot., datë 21.06.2023, për 6 subjekte;
- Nr. 6685 – 6691 prot., datë 08.06.2023, për 7 subjekte;
- Nr. 6546 – 6554 prot., datë 07.06.2023, për 9 subjekte;
- Nr. 8642 – 8646 prot., datë 03.07.2023, për 5 subjekte;
- Nr. 8981 – 8987 prot., datë 06.07.2023, për 7 subjekte;
- Nr. 9360 prot., datë 11.07.2023, për 1 subjekte;
- Nr. 10401 – 10403 prot., datë 21.07.2023, për 3 subjekte;
- Nr. 11828 – 11831 prot., datë 07.08.2023, për 5 subjekte;
- Nr. 12072 – 12076 prot., datë 10.08.2023, për 4 subjekte;
- Nr. 12218 prot., datë 11.08.2023, për 1 subjekte;
- Nr. 13006 – 13016 prot., datë 17.08.2023, për 10 subjekte;
- Nr. 13038 prot., datë 18.08.2023, për 1 subjekte;
- Nr. 13110 – 13116 prot., datë 21.08.2023, për 7 subjekte;
- Nr. 13213 – 13215 prot., datë 22.08.2023, për 3 subjekte;
- Nr. 14662 – 14663 prot., datë 19.09.2023, për 2 subjekte;
- Nr. 14393 – 14394 prot., datë 13.09.2023, për 2 subjekte;
- Nr. 16121 – 16129 prot., datë 23.10.2023, për 9 subjekte;
- Nr. 16229 – 16231 prot., datë 25.10.2023, për 3 subjekte;
- Nr. 16309 prot., datë 26.10.2023, për 1 subjekte;
- Nr. 16697 – 16701 prot., datë 03.11.2023, për 5 subjekte;
- Nr. 16702 prot., datë 06.11.2023, për 1 subjekte;
- Nr. 16846 prot., datë 07.11.2023, për 1 subjekte;
- Nr. 16900 – 16915 prot., datë 09.11.2023, për 16 subjekte;
- Nr. 16978 – 16983 prot., datë 10.11.2023, për 6 subjekte;
- Nr. 17739 dhe 17789 – 17791 prot., datë 30.11.2023, për 4 subjekte;
- Nr. 17914 – 17928 prot., datë 04.12.2023, për 15 subjekte;
- Nr. 18065 – 18068 prot., datë 06.12.2023, për 4 subjekte;
- Nr. 18331 – 18340 prot., datë 12.12.2023, për 10 subjekte;
- Nr. 18386 – 18393 prot., datë 13.12.2023, për 8 subjekte;
- Nr. 18871 – 18879 prot., datë 26.12.2023, për 6 subjekte;
- Nr. 19173 – 19175 prot., datë 29.12.2023, për 3 subjekte.

Gjithashtu janë hartuar dhe urdhrat e ekzekutimit si mëposhtë:

- Urdhër ekzektimi nr. 18383 prot., datë 13.12.2023;
- Urdhër ekzektimi nr. 18382 prot., datë 13.12.2023;
- Urdhër ekzektimi nr. 18381 prot., datë 13.12.2023;
- Urdhër ekzektimi nr. 18379 prot., datë 13.12.2023;
- Urdhër ekzektimi nr. 14113 prot., datë 08.09.2023;
- Urdhër ekzektimi nr. 11597 prot., datë 03.08.2023.

**Nga auditimit u konstatua se**, pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet e vitit 2023, nuk janë nxjerrë urdhrat përkatës subjektet debitorë për të ndërmarrë hapa të tjera bazuar në masat e parashikuara në kuadrin ligjor të sipër cituar.

### **Subjektet që janë debitorë për taksën e fjetjes në hotel**

Sipas VKB nr. 112, datë 31.10.2022, “Për miratimin e nivelit të taksave, tarifave vendore për shërbimet publike dhe ato administrative, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penaliteteve ndaj kundravajtësve”, pika A.3, baza e taksës konsiderohet numri i netëve të qëndruara në hotel për çdo person, ndërsa niveli i taksës ndahet në dy kategori sipas yjeve (hotel me 4 dhe 5 yje – 175 lekë dhe nën 4 yje – 100 lekë).

**Nga auditimi u konstatua se**, nga informacioni dhe dokumentacioni që bashkia disponon, për vitin 2022 rezultojnë debitorë në vlerën 881,510 lekë vlera ndërkohë që janë faturuar për vitin 2023 në vlerën 34,087,336 lekë dhe gjendja e debitorëve në mënyrë progresive **në fund të vitit 2023** është në vlerën **6,236,280 lekë, që përbën detyrim për arkëtim**, duke qenë se e gjithë vlera e mësipërme është njohur dhe kontabilizuar, (për më shumë informacioni shiko Aneksin nr. II.6.2).

### **Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve**

Në territorin e Bashkisë Lezhë për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë për vitin 2023, ushtrojnë këtë aktivitet 13 subjekte. Grupi i auditimit auditoi dokumentacionin lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqi<sup>7</sup> dhe pagesën e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore për vitet 2023.

**Nga auditimi u konstatua se**, nga informacioni dhe dokumentacioni që bashkia disponon, rezultojnë 13 subjekte që ushtrojnë aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, nga këto subjekte 4 prej tyre rezultojnë me detyrime në vlerë 2,000,000 lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4 “*Ushtrimi i veprimtarive në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre bëhet vetëm nga persona juridikë, pasi të jenë pajisur paraprakisht me lejet dhe autorizimet përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në mungesë të këtyre lejeve dhe autorizimeve, veprimtaria e kryer quhet e paligjshme*”. Neni 20-Autorizimet pika 2. “*Autorizimet për personat juridikë, që ushtrojnë veprimtarinë e parashikuara në pikat "ç" dhe "d" të nenit 11<sup>8</sup>, jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeje*”. Detyrimet e krijuara nga subjektet që ushtrojnë aktivitet tregtim lëndë djegëse me

<sup>7</sup>Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4, neni 20, pika 2.

<sup>8</sup>Ligji nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, neni 11 Personat juridikë, që i nënshtrohen këtij ligji, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së ushtruar, klasifikohen si vijon: ç) stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete; d) njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë”.

pakicë janë me vlerë totale 2,000,000 lekë që përbën detyrim për arkëtim në buxhetin e Bashkisë Lezhë, duke qenë se e gjithë vlera e mësipërme është njohur dhe kontabilizuar, sipas tabelës mëposhtë.

Nr	Subjekti	Adresa	NIPTI	Pajisur me licencë		Licenca		Fatura	Pagesa	Detyrimi
				Po	Jo	Fillon	Mbaron	Vlera		
1	G.	ISHULL, LEZHË	K.....T	Po		14.01.2022	13.01.2027	1,000,000	1,000,000	
2	G.	DAJÇ, LEZHË	K.....T	Po		26.01.2021	25.01.2026	1,000,000	1,000,000	
3	G.	LEZHË-SHKODËR, km1	K.....T	Po		29.12.2020	28.12.2025	1,000,000	1,000,000	
4	G.	LEZHË-TIRANË, km 1	K.....T	Po		29.12.2020	28.12.2025	1,000,000	1,000,000	
5	V.	LAGJE GURRA, LEZHË	K.....U	Po		16.09.2019	15.09.2024	1,000,000	1,000,000	
6	L	SHËNKOLL, LEZHË	K.....U	Po		18.10.2022	17.10.2027	1,000,000	1,000,000	
7	A.	SHËNKOLL, LEZHË	L.....F	Po		26.10.2021	25.10.2026	1,000,000	1,000,000	
8	O. ShPK	LEZHË-TIRANË, km 2	J.....I	Po		18.02.2022	17.02.2027	1,000,000	1,000,000	
9	K.	LEZHË-TIRANË, km 0	J.....P	Po		21.12.2022	20.12.2027	1,000,000	1,000,000	
10	K.	BALLDRE, LEZHË	J.....P	Po		02.12.2020	01.12.2025	1,000,000	400,000	600,000
11	K.	BLINISHT, LEZHË	J.....P	Po		02.12.2020	01.12.2025	1,000,000	400,000	600,000
12	P.	ZEJMEN, LEZHË	K.....P		Jo			1,000,000	800,000	200,000
13	R.	LEZHË-TIRANË, km 2	L.....Q		Jo			1,000,000	400,000	600,000
<b>TOTALI</b>								<b>13,000,000</b>	<b>11,000,000</b>	<b>2,000,000</b>

### **Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

1. Z. D. B., Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore për periudhën 01.01.2024-07.05.2024;
2. Z. D. P., Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore;
3. Z. I. D., Përgjegjës i Sektorit të Mbledhjes dhe Menaxhimit të Borxhit;
4. Zj. A. Gj., Përgjegjës i Sektorit të Administrim Biznesit;
5. Z. A. L., Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban.

### **3. AUDITIM MBI VLERËSIMIN E RAPORTIMIT FINANCIAR, PËR TË ARRITUR NË OPINIONIN NË SE PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN 2022, JAPIN NJË PARAQITJE TË VËRTETË E TË DREJTË TË POZICIONIT FINANCIAR, PERFORMANCËS FINANCIARE DHE FLUKSIT TË PARASË, BAZUAR NË KUADRIN RREGULLATOR NË FUQI.**

Për trajtimin e kësaj çështjeje, nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Pasqyrat Financiare për periudhën ushtrimore raportuese (janar-dhjetor 2023).
- Ditarët e kontabilitetit për periudhën raportuese ushtrimore viti 2023.
- Listë pagesat me përzgjedhje të periudhës raportuese ushtrimore e vitit 2023.
- Dokumentet e bankës dhe të arkës për periudhën raportuese ushtrimore të vitit 2023.
- Akt-rakordimet e kryera me degën e thesarit Lezhë për periudhën raportuese të vitit 2023.
- Dokumentet e inventarizimit fizik të AAGJM, etj, për periudhën raportuese ushtrimore viti 2023.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultoi se:

Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:



Për vitin 2023 Bashkia Lezhë ka hartuar pasqyrat e konsoliduara. Bashkia Lezhë për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Lezhë si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestimi.

### **Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.**

Për vitin 2023 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.

Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).

Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Floë).

Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.

Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.

Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.

Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).

Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).

Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

### **Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare**

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të Bashkisë Lezhë për vitin 2023 janë të nënshkruara nga z. P. N. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues, znj. B. V. me detyrë Drejtor i Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe znj.M. Ll. me detyrë përgjegjës i sektorit të kontabilitetit dhe janë depozituar pranë Degës së Thesarit Lezhë në datë 28.03.2023, në përputhje me afatet e përcaktuara me ligj.

Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.

Për vitin 2023 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

-Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);

- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;

-Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

-Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;

-Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

-Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditareve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

### **Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:**

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

- Regjistrimet kontabël mbahen në programin financiar Alpha.

- Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj por nuk janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitore. Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumentacionit bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listëpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Lezhë për aktivitetin ekonomiko- financiar 01.01.2023 deri më datën 31.12.2023.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike; Totali i Aktivit për vitin 2022 është në vlerën 10,877,961,341 lekë dhe për vitin 2023 është 11,221,742,100 lekë.

### **Auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2023:**

Në hartimin e bilancit është zgjedhur që nënzërat e bilancit të paraqiten drejtpërdrejtë në pasqyrën e bilancit.

**Pasqyra e pozicionit financiar** të Bashkisë Lezhë në 31.12.2023, sipas formatit F1, është paraqitur më poshtë:

#### **1.Pasqyra e pozicionit financiar (F1).**

- **Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet=4,484,789,892 lekë.**

- Aktivet 11,221,742,100 lekë

- Detyrimet 866,290,548 lekë

- Aktivet Neto 10,355,451,552 lekë

#### **Aktivet afatshkurtra:**

Aktivet afatshkurta më datë 31.12.2023 paraqiten në vlerën 1,305,481,992 lekë dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 538,729,797 lekë;

- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 77,388,0723 lekë;

- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 524,085,770 lekë

#### **Fondi i Konsoliduar:**

##### **Llogaria 101 “Teprica (Fondi I akumuluar/Deficit i akumuluar)**

Në llogarinë 101 është paraqitur në vlerën 6,085,647,215 lekë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në Pasqyrën më poshtë.

#### **Pasqyra PF1: Detajet e nënrubrikës ‘Teprica’.**

Zërat për të cilat pakësohet fondi	Llogaria 101		Zërat për të cilat shtohet fondi
	Debi	Kredi	
Nxjerrje jashtë përdorimit	35,685,995	6,328,164,500	Çelje
Amortizim i vitit	290,654,665	85,795,020	Investime + Dhurime
		(2,796,757)	Ndryshim i gjendjes së inventarit
	326,340,660	6,411,162,763	
<b>Shuma</b>		<b>6,084,822,103</b>	

Burimi: Bashkia Lezhë

Sipas tabelës së mësipërme e përlllogaritur dhe sipas udhëzimit të MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” vlera e raportuar në bilanc është 6,085,647,215 lekë e cila ka mbivlerësuar llogarinë 101 “Teprica” për vlerën 825,112 lekë.

**Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhet nga:**

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 536,173,751 lekë, përbëhet nga gjendja e llogaria 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" në shumën, 362,445,984 lekë dhe gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 173,727,767 lekë.

Lëvizjet e klasës 5“Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre”, paraqitet në aneksin nr.3/1 në anekset e Raportit të auditimit.

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 536,173,751 lekë kuadron me llogaritë 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" dhe 466 "Mjete në ruajtje".

**Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:**

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Lezhë në 31.12.2023 paraqitet në vlerën 77,388,073 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 11,727,915 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” në vlerën 65,660,157 lekë.

Lëvizjet e klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, paraqitet në aneksin nr.3/2 në anekset e Raportit të auditimit.

Nga verifikimi me zgjedhje sipas ditarit të bankës u verifikuan disa shpenzime për të cilat u kërkua dokumentacion justifikues nga magazina për hyrjet dhe daljet e këtyre mallrave.

Sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion për të gjitha shpenzimet e mëposhtme disponohet dokumentacioni i mëposhtëm:

-Urdhër furnizim hyrje (e firmosur nga përgjegjësi i financës)

-Fletë hyrje në magazinë

-Urdhër furnizim shpërndarje sipas kërkesave (e firmosur nga përgjegjësi i financës)

-Fletë dalje nga magazine.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën =2,796,759 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën 2,796,756 lekë.

**Llogaria 312 “Materiale”,** ka vlerën 11,727,915 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	13,478,877
Hyrje në magazinë gjatë vitit 2023	115,179,750
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	116,930,712
<b>Gjendja në 31.12.2023</b>	<b>11,727,915</b>

Burimi: Bashkia Lezhë

**Llogaria 327 “Objekte inventari”,** është pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerë 65,660,157 lekë dhe përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor. Gjatë vitit 2023 kjo llogari ka pasur shtesa në vlerën 20,000 dhe pakësime në vlerën 1,065,794 lekë nga nxjerrjet nga përdorimi.

Lëvizjet e llogarisë 32 “Objekte inventari” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	66,705,952
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	20,000
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	1,065,794
<b>Gjendja në 31.12.2023</b>	<b>65,660,157</b>

Burimi: Bashkia Lezhë

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Titullari i Bashkisë Lezhë ka nxjerrë Urdhrat e inventarizimit ku janë përcaktuar grupi për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve. Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit".

### **Inventarizimi i aktiveve:**

Gjatë vitit 2023, mbështetur dhe në udhëzimin nr.30 datë 27.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik" nga ana e Titullarit të Bashkisë është konceptuar dhe firmosur urdhri nr.165 datë 23.05.2023 për ngritjen e komisionit të inventarizimit, dhe vlerësimin të aktiveve për vitin 2023 të Bashkisë Lezhë.

Me urdhër të Titullarit të Institucionit nr.165, datë 23.05.2023 është ngritur komisioni për vlerësimin/seleksionimit e aktiveve të propozuara për dalje është i përberë nga:

- 1-P. M. (Kryetar)
- 2-R. A. (Anëtar)
- 3-E. Gj. (Anëtar)
- 4-M. M. (Anëtar)
- 5-E. S. (Anëtar)
- 6-E. S. (Anëtar)
- 7-Gj. L. (Anëtar)
- 8-E. M. (Anëtar)
- 9-F. M.(Anëtar)

Komisioni i vlerësimin dhe seleksionimit ka mbajtur relacionin për materialet e propozuara për dalje nga përdorimi me vlerë 21,312,670 lekë.

Me urdhër nr.175, datë 02.06.2023 për miratimin e nxjerrjes jashtë përdorimit të disa materialeve të rezultuara nga inventarizimi u vendos.

Dalja e materialeve si mëposhtë:

Llogaria 241 materiale me vlerë kontabël 498,229 lekë.

Llogaria 218 materiale me vlerë kontabël 19,748,647 lekë.

Llogaria 327 materiale me vlerë kontabël 1,065,794 lekë.

Vlera totale e materialeve të nxjerra jashtë përdorimit është në shumën 21.312,670 lekë

Bashkia Lezhë në kundërshtim me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pika 96, nuk ka ngritur komision për asgjësimin e aktiveve por është vazhduar praktika për nxjerrjen nga përdorimi sipas relacionit të komisionit të inventarizimit dhe vlerësimin.

Titullari i Institucionit ka autorizuar komisionin për vlerësimin/seleksionimin e aktiveve të propozuara për dorëzimin e materialeve të propozuara për nxjerrja jashtë përdorimit.

Në datën 08.11.2023 në ambientet e Bashkisë Lezhë është mbajtur procesverbali i dorëzimit të aktiveve për tu nxjerrë nga përdorimi. Komisioni i vlerësimin/seleksionimit të aktiveve të propozuara për nxjerrje nga përdorimi në prani të personave të autorizuar nga operatori fitues për asgjësimin e materialeve dhe përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Mjedis ka dorëzuar materialet e nxjerra jashtë përdorimit. Praktika e asgjësimin të materialeve është kryer nga operatori ekonomik i shpallur fitues për këtë procedurë.

#### **Llogaritë Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme ”&“Të tjera aktive afatshkurtra”:**

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në aneksin nr.3/3 në anekset e Raportit të auditimit.

**Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”,** e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, gjendje e cila në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 512,259,280 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 439,693,886 lekë. Gjatë vitit 2023 kanë ndodhur ndryshimet e mëposhtme:

Me VKB nr.86, datë 27.12.2023 janë sistemuar debitorë me vlerë detyrimi 29,905,761 lekë. Kjo vlerë detyrimi i përket periudhave para vitit 2010, gjithashtu është sistemuar edhe vlera e debitorëve nga ish-komunat prej 78,572,380 lekë. Veprime e mësipërme kanë sjellë pakësim të llogarisë 468 “Debitorë” prej 108,478,142 lekë.

Gjithashtu shtesat e llogarisë 468 gjatë vitit 2023 nga veprimtaria e Bashkisë Lezhë rezultojnë në vlerën 31,693,432 lekë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në Pasqyrën më poshtë.

#### **Pasqyra PF2: Detajet e nënrubrikës “Debitorë të ndryshëm”.**

<b>Emërtimi i llogarive</b>	<b>Vlera</b>
Debitor biznese	278,387,808
Debitor gjopa policia bashkiake	143,000
Gjopa IMTV	102,309,530
Debitor për kopshtet dhe çerdhet	1,198,235
Debitor karburantet	2,000,000
Debitor legalizimet	5,866,613
Debitor nga Raportet e KLSH	49,788,700
<b>Totali</b>	<b>439,693,886</b>

Burimi: Bashkia Lezhë

**Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”**, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 84,391,882 lekë dhe kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila është paraqitur në vlerën 784,391,882 lekë. Vlera prej 84,391,882 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, si dhe përbëhet nga:

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në Pasqyrën më poshtë.

#### **Pasqyra PF3: Detajet e nënrubrikës “Të tjera operacione me shtetin”.**

<b>Emërtimi i llogarive</b>	<b>Vlera</b>
Llogari 401-408	33,615,932
Paga personeli llog 42	36,488,939
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	2,009,462
Sigurime shoqërore llog.435	10,689,190
Sigurime shëndetësore llog.436	1,483,398
Organizma të tjerë shtetërorë	104,961
<b>Totali</b>	<b>84,391,882</b>

Burimi: Bashkia Lezhë

Nga analiza e mësipërme llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” është paraqitur saktë dhe kuadron me llogaritë e klasës 4.

### **Aktivet Afatgjata jomateriale (AAJM)**

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivet Afatgjata Jo materiale”, përbëhen nga llog.202 “Studime dhe Kërkime”, dhe paraqiten me kosto historike 38,396,671 lekë, amortizim të akumuluar në vlerën 26,477,871 lekë dhe vlerë neto 11,918,800 lekë. Nga auditimi i llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” kjo llogari nuk është e analizuar dhe nuk ka informacion çfarë projekte janë përfshirë në këtë llogari. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në Pasqyrën më poshtë.

### **Pasqyra PF4: Detajet e nënrubrikës “Studime dhe Kërkime”.**

<b>Kosto Historike 31.12.2022</b>	<b>Amortizim i Akumuluar 2022</b>	<b>Shtesa 2023</b>	<b>Pakësime 2023</b>	<b>Amortizim 2023</b>	<b>Vlera kontabël neto 31.12.2023</b>
38,396,671	24,374,553	-	-	2,103,318	11,918,800

Burimi: Bashkia Lezhë

### **Aktivet e afatgjata materiale (AAM)**

Llogaritë e Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale”, AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2022, paraqiten me tepricë neto 6,231,711,666 lekë. Në vitin 2023, AAM-të paraqitet me vlerë neto 5,993,269,344 lekë. Gjatë viti 2023 kemi pasur shtesë të AAM-ve blerje me pagesë në shumën 85,795,020 lekë, shtesat kanë ardhur kryesisht si rezultat i investimeve të ndryshme në rrugë, rrjete, vepra ujore dhe blerje , në Bashkinë Lezhë dhe NJ.A Administrative. Pakësimet nga amortizimit gjatë vitit 2023 kanë qenë në vlerën 290,654,665 lekë dhe pakësime nga nxjerrje jashtë përdorimi ose lëvizje ndërmjet llogarive kanë qenë në shumën 35,685,995 lekë. Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 05 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në Pasqyrën më poshtë.

### **Pasqyra PF5: Detajet e nënrubrikës “Aktive afatgjata materiale”.**

<b>Nr Llog</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Teprica neto në 31.12.2022</b>	<b>Shtesa 2023</b>	<b>Amortizim 2023</b>	<b>Pakësime 2023</b>	<b>Gjendja me 31.12.2023</b>
210	Toka, Troje, Terrene	1,085,472,103	-		-	1,085,472,103
211	Pyje, Kullota, Plantacione	32,209,779	286,560	1,601,732	-	30,894,607
212	Ndërtime e Konstruksione	3,079,665,003	-	154,068,480		2,925,596
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	1,875,468,770	19,363,600	94,741,619		1,800,090,752
214	Instalime dhe paisje	11,933,751	21,592,161	6,553,344	759,193	26,213,375
215	Mjete Transporti	43,842,905	-	8,768,581	-	35,074,324
218	Inventar Ekonomik	103,119,354	44,552,699	22,817,592	34,926,802	89,927,659
	<b>Shuma</b>	<b>6,231,711,666</b>	<b>85,795,020</b>	<b>288,551,347</b>	<b>35,685,995</b>	<b>5,993,269,344</b>

Burimi: Bashkia Lezhë

**1. Llogaria 210 “Toka, troje terrene”** është paraqitur në bilanc me vlerë neto kontabël 1,085,472,103 lekë. Gjatë vitit 2023 nuk ka pasur ndryshime në llogarinë 210 “Toka, troje terrene”.

Në këtë llogari vlera prej 1,050,872,186 lekë është regjistruar si aktiv i vetëm e pa analizuar dhe nuk dihet çfarë përfaqëson. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në Pasqyrën më poshtë.

**Pasqyra PF6: Detajet e nënrubrikës “Toka, troje, terrene”.**

Kosto Historike 31.12.2022	Amortizim i Akumuluar 2022	Shtesa 2023	Pakësime 2023	Amortizim 2023	Vlera kontabël neto 31.12.2023
1,085,472,103	-	-	-	-	1,085,472,103

Burimi: Bashkia Lezhë

**2. Llogaria 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”**

Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” në datën 31.12.2023 paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar me kosto historike 56,761,1000 lekë, amortizim i akumuluar me vlerë 26,551,321 lekë dhe me vlerë kontabël neto 30,894,608 lekë. Gjatë vitit 2023 në llogarinë 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” ka pasur shtesa në vlerën 286,560 lekë për aktivin “Fidanë, Shegë Drejtoria e Bujqësisë”.

Llogaria 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” është amortizuar për vlerë 26,153,052 lekë në kundërshtim me udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 36.

Në këtë llogari janë kontabilizuar aktive “Pemë Drejtoria e Bujqësisë” me vlerë neto 461,700 lekë dhe “Fidanë shegë” me vlerë 272,232 lekë në kundërshtim me udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Këto aktive duhet të kontabilizoheshin në klasën 3 të aktive sepse janë mallra nuk i plotësojnë kushtet për tu kontabilizuar për AAM.

**Pasqyra PF7: Detajet e nënrubrikës “Pyje, Kullota, Plantacione”.**

Kosto Historike 31.12.2022	Amortizim i Akumuluar 2022	Shtesa 2023	Pakësime 2023	Amortizim 2023	Vlera kontabël neto 31.12.2023
56,761,100	24,551,321	286,560	-	1,601,732	30,894,607

Burimi: Bashkia Lezhë

**3. Llogaria 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”** e cila pasqyron gjendjen e 170 aseteve për llogari të Bashkisë Lezhë, në fund të vitit 2023 rezulton me vlerë neto kontabël 2,925,596,523 lekë.

Gjatë vitit 2023 llogaria 212 “Ndërtesa Konstruksione” nuk ka pasur shtesa dhe është pakësuar vetëm nga amortizimi i vitit në vlerën 154,068,480 lekë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në Pasqyrën më poshtë.

**Pasqyra PF8: Detajet e nënrubrikës “Ndërtesa Konstruksione”.**

Kosto Historike 31.12.2022	Amortizim i Akumuluar	Shtesa 2023	Pakësime 2023	Amortizim 2023	Vlera kontabël neto 31.12.2023
4,396,982,390	1,317,317,387	-	-	154,068,480	2,925,596,523

Burimi: Bashkia Lezhë



**4. Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”** e cila pasqyron gjendjen e 177 asetëve për llogari të Bashkisë Lezhë, në fund të vitit 2023 rezulton me vlerë neto kontabël 1,800,090,752 lekë. Gjatë vitit 2023 kjo llogari është shtuar për vlerën 19,363,600 lekë për 2 (dy) aktive si mëposhtë:

1-Sistemim -Asfaltim Rr.Roboshtë me vlerë 10,265,400 lekë (investim i ri)

2-Sistemim-Asfaltim rrugët e brendshme Troshan me vlerë 9,098,200 lekë (investim i ri).

Llogaria 213 gjatë vitit 2023 është pakësuar vetëm nga amortizimi i vitit në vlerën 94,741,619 lekë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në Pasqyrën më poshtë.

**Pasqyra PF9: Detajet e nënrubrikës “Rrugë, rrjete, vepra ujore”.**

Kosto Historike 31.12.2022	Amortizim i Akumuluar	Shtesa 2023	Pakësime 2023	Amortizim 2023	Vlera kontabël neto 31.12.2023
2,638,470,909	763,002,139	19,363,600	-	94,741,619	1,800,090,752

Burimi: Bashkia Lezhë

**5. Llogaria kontabël 214 “Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune”.**

Kjo llogari përfaqëson makineri paisje dhe vegla pune në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Lezhë. Sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Lezhë gjendja e llogarisë 214 më datë 31.12.2023 paraqitet me vlerën kontabël neto 26,213,375 lekë. Krahasuar me vitin 2022 llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune” është shtuar me vlerën 14,279,625 lekë. Gjatë vitit 2023 kjo llogari ka pasur shtesa në vlerën 21,592,161 lekë. Amortizimi i vitit 2023 është në vlerën 6,553,344 lekë. Pakësimet nga nxjerrja jashtë përdorimit është në vlerën 759,193 lekë, këto aktive janë të amortizuara dhe janë nxjerrë nga përdorimi nga komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në Pasqyrën PF më poshtë.

**Pasqyra PF10: Detajet e nënrubrikës “Inventar Ekonomik”.**

Kosto Historike 31.12.2022	Amortizim i Akumuluar	Shtesa 2023	Pakësime 2023	Amortizim 2023	Vlera kontabël neto 31.12.2023
58,536,332	46,602,581	21,592,161	759,193	6,553,344	26,213,375

Burimi: Bashkia Lezhë.

**6. Llogaria 215 “Mjete transporti”.** Kjo llogari paraqet vlerën e mjeteve të transportit në pronësi të Bashkisë Lezhë më datë 31.12.2023 me vlerë neto kontabël 35,074,324 lekë e cila përbëhet prej 32 mjeteve.

Kjo llogari gjatë vitit 2023 nuk ka pasur shtesa dhe është pakësuar vetëm nga amortizimi vjetor për vlerën 8,768,581 lekë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në Pasqyrën PF më poshtë.

**Pasqyra PF11: Detajet e nënrubrikës “Mjete Transporti”.**

Kosto Historike 31.12.2022	Amortizim i Akumuluar	Shtesa 2023	Pakësime 2023	Amortizim 2023	Vlera kontabël neto 31.12.2023
99,298,838	55,455,933	-	-	8,768,581	35,074,324

Burimi: Bashkia Lezhë

**7. Llogaria kontabël 218 “Inventar ekonomik”.** Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Lezhë.

Sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Lezhë gjendja e llogarisë 218 më datë 31.12.2023 paraqitet me vlerën kontabël neto 89,927,659 lekë. Krahasuar me vitin 2022 llogaria 218 “Inventar ekonomik” është pakësuar me vlerën 13,191,695 lekë. Gjatë vitit 2023 kjo llogari ka pasur shtesa në vlerën 44,552,699 lekë. Amortizimi i vitit 2023 është në vlerën 22,817,592 lekë. Pakësimet nga nxjerrja jashtë përdorimit dhe lëvizje midis aktiveve janë në vlerën 34,926,802 lekë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në Pasqyrën PF18 më poshtë.

**Pasqyra PF12: Detajet e nënrubrikës “Inventar Ekonomik”.**

Kosto Historike 31.12.2022	Amortizim i Akumuluar	Shtesa 2023	Pakësime 2023	Amortizim 2023	Vlera kontabël neto 31.12.2023
283,516,588	180,397,234	44,552,699	34,926,802	22,817,592	89,927,659

Burimi: Bashkia Lezhë

**Llogaria 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM:** Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Lezhë në fund të vitit 2023, paraqitet në vlerën (2,702,355,813) lekë që ka të bëjë me amortizimin e akumuluar me datë 31.12.2023. Krahasuar me vitin 2022 llogaria 219 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara” paraqitet me shtesë prej (290,654,664) lekë, shtesë e cila ka të bëjë me amortizimin vjetor të vitit 2023.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në aneksin nr.3/4 në anekset e Raportit të auditimit të auditimit.

**Testi substancial i amortizimit**

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 05 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të llogaritura nga Bashkia Lezhë, janë si më poshtë:

- ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje 5 %
- inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi baze grupimi) 20 %
- për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi) 25%
- për mjetet e transportit 20%
- për aktivet afatgjata jomateriale (metoda lineare) 15 %

**Aktivet Afatgjata Financiare**

Aktive Afatgjata Financiare rezultojnë në fund të vitit 2023 në vlerën 3,071,000 lekë. Kjo vlerë e regjistruar në pasqyrën e pozicionit financiar i përket kuotave të Bashkisë Lezhë në shoqërinë “Shoqëria Rajonale Ujësjetillës Kanalizime Lezhë” sh.a me NUIS M28314503C ku Bashkia Lezhë ka 30.71% të kuotave.

-Bashkia Lezhë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 30.71% të aksioneve të “Shoqëria Rajonale Ujësjetillës Kanalizime Lezhë” sh.a me NUIS M28314503C e cila është shoqëri aksionere me objekt, “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit(eve) të furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve”.

Numri i aksioneve është 30,710 me vlerë nominale 100 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 3,071,000 lekë.

Regjistrimi i mësipërm është në përputhje me Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në Pjesëmarrje”.

### **Investimet:**

Referuar pasqyrës së pozicionit financiar, gjendja e llogarisë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” është paraqitur në vlerën 102,665,632 lekë kjo llogari nuk ka pasur shtesa gjatë vitit 2023. Llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në datën 31.12.2023 paraqitet në vlerën 3,805,335,333 lekë, gjatë vitit 2023 kjo llogari ka pasur shtesa në shumën 677,931,605 lekë.

Bashkia Lezhë për llogarinë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” nuk i ka vendosur grupi të auditimit një listë analitike për projektet të cilat janë të kontabilizuara në këtë llogari. Për llogarinë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” grupit të auditimit i janë vendosur në dispozicion vetëm procedurat e prokurimit për periudhën 2020-2023, operatorët e shpallur fitues dhe vlerën e kontratës. Në këtë llogari referuar Udhëzimin Nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.8, datë 09.03.2018” kontabilizohen shpenzime për aktive afatgjata në proces dhe në momentin e përfundimit të projektit dhe marrjes në dorëzim këto investime kontabilizohen në klasën 2 të aktivitetit.

### **PASIVET (DETYRIMET)**

#### **Pasivet Afatshkurtra**

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Lezhë më datë 31.12.2023, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2023, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2023, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

#### **Pasqyra PF13: Detajet e nënrubrikës “Llogari të pagueshme”.**

<b>Llogaritë</b>		<b>Viti 2023</b>	<b>Viti 2022</b>	<b>Diferenca</b>
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	33,615,932	78,809,807	(45,193,875)
42	Detyrime ndaj personelit	36,488,939	31,504,215	4,984,724
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	2,009,462	1,597,944	411,518
435	Sigurime shoqërore	10,689,190	9,205,073	1,484,117
436	Sigurime shëndetësore	1,483,398	1,277,439	205,959
437,438	Organizma të tjera shtetërore	104,961	108,847	(3,886)
467	Kreditor të ndryshëm	165,278,352	89,831,039	75,447,313

Burimi: Bashkia Lezhë

**Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”,** në fund të vitit 2023 është paraqitur në vlerën 33,615,932 lekë dhe paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Lezhë më 31.12.2023. Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në aneksin nr.3/5 në anekset e Raportit të auditimit. Referuar faturave të palikujduara të cilat janë kontabilizuar në këtë llogari për periudhën nëntor-dhjetor 2023 janë 3 fatura tatimore me vlerë detyrimi 8,433,132 lekë. Detyrimi për faturat për të cilat u ka kaluar afati 60 ditor janë në vlerën 25,182,799 lekë.

Vlera e faturave të palikujduara për të cilat ju ka kaluar afati 60 ditor i likuidimit janë kontabilizuar edhe në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në kundërshtim me udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.Ky veprim kontabël ka sjell shtrembërim të informacionit kontabël.

**Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”,** sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Bashkisë Lezhë, paraqitet në vlerën 36,488,939 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës, dhe janë paguar ne muajin janar 2024 në vlerën 36,488,939 lekë.

**Llogaria 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”,** paraqitet në vlerën 2,009,462 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor është paguar në janar 2024 në vlerën 2,009,462 lekë.

**Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar dhe janë përkatësisht në vlerat 10,689,190 lekë dhe 1,483,398 lekë.

**Llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”,** sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Lezhë, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 173,727,767 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Vlera e mësipërme është e rakorduar me Degën e Thesarit Lezhë.

Nga analiza e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, konstatohet se në këtë llogari vazhdojnë të jenë të ngurtësuara fonde në vlerën 12,277,346 lekë për të cilat ka kaluar afati i garancisë. Në aneksin nr3/6 në anekset e Raportit të auditimit gjenden garancitë e ngurtësuara në llogarinë 466” Kreditorë për mjete në ruajtje” të cilat duhet të çregjistrohen nga kjo llogari.

Sistemimi i vlerës totale të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” duhet të bëhet duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Veprimet dhe mosveprimet janë në mos respektim të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 50, dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

**Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”,** sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Lezhë, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 165,278,352 lekë dhe përfaqëson vlerën e detyrimeve të Bashkisë Lezhë për kontratat e investimeve. Gjatë vitit 2023 kjo llogari është shtuar me vlerën 75,447,313 lekë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në Pasqyrën PF14 më poshtë.

Lloji i detyrimit	Detyrimi i krijuar në vitin 2023	Detyrime progresive
Detyrim Prapambetur për vendime gjyqësore	4,271,250	4,271,250
Detyrim i prapambetur për shërbime	7,055,110	36,069,604
Detyrim i prapambetur për investime	49,068,529	99,679,700
Detyrim i prapambetur për mallra	15,052,424	25,257,798
<b>Totali</b>	<b>75,447,313</b>	<b>165,278,352</b>

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” është mbivlerësuar për vlerën 25,108,199 lekë e cila përbëhet prej 17 faturave tatimore për mallra. Këto fatura janë regjistruar në llogarinë 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”, Regjistrimi në llogarinë 467 ka sjell pasqyrim jo real të llogarive kontabël. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

**Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”,** sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Lezhë, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 165,278,352 lekë.

Referuar udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, kjo llogari përpara mbyllje së llogarive vjetore duhet të kryejë mbylljen e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në debi të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

### **Pasqyra e Performancës Financiare:**

Analizë e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare” të PF të vitit 2023 paraqitet në aneksin nr.3/6 anekset e Raportit të auditimit.

**Analiza e llogarive të të ardhurave** për vitin 2023, të cilat në total janë në vlerën 2,038,537 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin Lezhë paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike **70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 378,715,245 lekë, e cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë analitike **7002 “Tatim mbi Biznesin e vogël”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 900,608 lekë e cila përfshin taksën mbi Biznesin e vogël ,e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

b. Gjendja e llogarisë **7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 95,089,795 lekë e cila përfshin taksën mbi ndërtesën dhe truallin, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me Thesarin.

c. Gjendja e llogarisë **7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 282,724,842 lekë e cila përfshin taksa e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, zënie hapësire publike, qiratë për truallin etj.

- Gjendja e llogarisë **71 “Të ardhurat jo tatimore”** paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 138,860,976 lekë, i cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë **7109 “Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia”** paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 5,582,370 lekë, e cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

b. Gjendja e llogarisë **711 “Shërbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare”** paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 133,278,606 lekë, e cila përfshin tarifatat e parkimit, kamat vonesa, tarifa transporti, licenca etj. Kjo vlerë me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

**Analiza e llogarive të shpenzimeve** në vitin 2023, të cilat në total janë në vlerën 1,676,091,108 lekë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë **600 ‘Paga, shpërblime e të tjera personeli’** për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 514,191,440 lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën 284,985,178 lekë diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë **601 ‘Kontribute për sigurime’** për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 84,614,116 lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën 84,614,116 lekë, diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë **602 ‘Blerje mallra e shërbime’** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 323,199,085 lekë dhe sipas akt-rakordimit me Thesarin është në vlerën 323,199,085 lekë , diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **606 ‘Transferime për Buxhetet familjare e Individë’** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 735,062,605 lekë, dhe sipas aktrakordimit me Thesarin.

Për vitin 2023 totali i te ardhurave ne vlere është 2,038,537,093 lekë dhe totali shpenzimeve është 1,676,091,108 lekë. Diferenca e tyre ne vlerën 362,445,984 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit”.

**Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga dhe shpërblime etj, për Bashkinë Lezhë).**

***-Testimi i llogarisë 600 “Pagat dhe shpërblime”***

**Për vitin 2023** numri i punonjësve është miratuar me VKB Nr.62 datë 23.12.2022. Miratuar në total numri 773 punonjës.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Lezhë, është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara. Sipas listë pagesave të muajve janar dhe dhjetor 2023 konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listë pagesat janë të firmosura nga Drejtori i Financës z. B. V. dhe nga specialistet e pagave. Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Drejtori i Financës dhe nga Kryetari Bashkisë. Janë mbajtur listë prezencat dhe janë të firmosura nga Drejtor i Burimeve Njerëzore znj. J. L.

**Hartimi i listë pagesave mbi bazën e listë prezencave të nënshkruara nga përpiluesi, për vitin 2023.**

Me përzgjedhje u audituan listë pagesat e periudhës (Janar dhe Dhjetor 2023) dhe konstatohet se ato plotësohen sipas rregullave të përcaktuara të cilat janë plotësuar mbi bazën e listë prezencave mujore. Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore është hartuar përmbledhësja në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995,” Kodi i Punës”, i ndryshuar.

Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimeve shoqërore të punonjësve të Bashkisë Lezhë, janë në përputhshmëri me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 "Për tatimin mbi të ardhurat", me ndryshime dhe ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH”.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Lezhë, është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara.

Sipas listë pagesave të muajve (Janar dhe Dhjetor 2023)konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listë pagesat janë të firmosura nga Drejtori i Financës znj. B. V. dhe nga specialistet e pagave. Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Drejtori i Financës z. B. V. dhe nga Kryetari Bashkisë z. P. N..

Tabela e burimit të Financimit të pagave paraqitet në **Pasqyrën PF15** më poshtë:

000/lekë

Periudha	Plan	Fakt	%	Burimi i financimit			
				Trans. e Pakush.	Të ardhura	Trans. e Kushtëzuar	Transferte specifike
Viti 2023	581,352	512,194	88	314,398	8,429	13,999	175,67

Burimi: Bashkia Lezhë

Realizimi i fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe fondit të veçantë paraqitet në **Pasqyrën PF16** më poshtë:

000/lekë

Nr.	Emërtimi	VITI 2023		
		Plani	Fakti	%
1	F. Pagave	581,352	284,674	88
2	F. Sig. Shoq	97,004	84,613	87

Burimi: Bashkia Lezhë

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi, Kryetari i Bashkisë z. P. N., znj. B. V. Drejtor i Financës në cilësinë e nënpunësit zbatues dhe znj. M. Ll. Përgjegjës i Sektorit të Kontabilitetit.*

Për pikën 3 të Raportit të Auditimit është mbajtur akt- konstatim nr.3 datë 11.10.2024

#### **4. AUDITIM MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E STRUKTURAVE MBI ADMINISTRIMIN E PRONËS PUBLIKE (ASETE DHE PYJE E KULLOTA) TË TRASNFERUARA SIPAS VKM.**

Në zbatim të pikes 4 të programit të auditimit: “*Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Asete dhe Pyje Kullotave) të trasferuara sipas VKM*” u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Inventarët e aseteve të kaluara me VKM Bashkisë dhe NJA nga Pushteti Qendror.
2. Listat e aseteve të kaluara në pronësi të Bashkisë së bashku me certifikatat hipotekore, si dhe lista e aseteve për të cilat janë përgatitur dokumentet tekniko-ligjore të depozituar në ASHK për pajisjen e Bashkisë me certifikatë hipotekore pronësie për këto asete.

***Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:***

Asetet e kaluara nga pushteti qendror pranë Bashkisë Lezhë paraqiten, sipas VKM-ve:

- Për **Bashkinë Lezhë** (Bashkia Qendër) është miratuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim të Bashkisë

Lezhë, me VKM nr. 414, datë 11.07.2007 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Lezhë të Qarkut të Lezhës”, sipas lidhjes nr.1 me 59 fletë dhe përfundon me numër rendor 291 dhe përmban 291 prona të transferuara, ndryshuar me VKM nr. 1686, datë 24.12.2008 ku janë shtuar edhe 199 prona.

- Për **ish Komunën Balldre** është miratuar lista e inventarit me VKM nr.242, datë 06.12.20211 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Balldre, Qarku Lezhë”. Lista e inventarit me 130 fletë përfundon me numrin rendor 941 dhe përmban 941 prona.
- Për **ish Komunën Blinisht** është miratuar lista përfundimtare e pronave me VKM nr. 730, datë 23.11.2005 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Blinisht, Qarku Lezhë. Lista e inventarit me 50 fletë përfundon me numrin rendor 322 dhe përmban 322 prona.
- Për **ish Komunën Zejmen** është miratuar lista e inventarit me VKM nr. 8, datë 07.01.2009 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në Komunën Zejmen të Qarkut të Lezhës”, sipas lidhjes nr.1 me 33 fletë dhe përmban 194 prona.
- Për **ish Komunën Dajç** është miratuar lista e inventarit me VKM nr. 707, datë 12.10.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Dajç, të Qarkut Lezhë”, sipas lidhjes nr.1 me 42 fletë dhe përmban 156 prona.
- Për **ish Komunën Kallmet** është miratuar lista e inventarit me VKM nr. 725, datë 01.07.2009 “Për miratimin e listës paraprake të inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Kallmet, të Qarkut Lezhë”, sipas lidhjes nr.1 me 55 fletë dhe përmban 285 prona.
- Për **ish Komunën Kolsh** është miratuar lista e inventarit me VKM nr. 201, datë 13.03.2013 “Për miratimin e listës paraprake të inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Kolsh, të Qarkut Lezhë”, sipas lidhjes nr.1 me 33 fletë dhe përmban 197 prona.
- Për **ish Komunën Shëngjin** është miratuar lista e inventarit me VKM nr. 682, datë 26.09.2012 “Për miratimin e listës paraprake të inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Shëngjin, të Qarkut Lezhë”, sipas lidhjes nr.1 me 55 fletë dhe përmban 362 prona.
- Për **ish Komunën Shënkoll** është miratuar lista e inventarit me VKM nr. 194, datë 06.03.2013 “Për miratimin e listës paraprake të inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Shënkoll, të Qarkut Lezhë”, sipas lidhjes nr.1 me 70 fletë dhe përmban 1258 prona.
- Për **ish Komunën Ungrej** është miratuar lista e inventarit me VKM nr. 564, datë 22.08.2012 “Për miratimin e listës paraprake të inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Ungrej, të Qarkut Lezhë”, sipas lidhjes nr.1 me 87 fletë dhe përmban 600 prona.

Nga auditimi rezulton se referuar listave të miratuara të inventareve si më lart, Bashkia Lezhë zotëron në total 4473 asete, nga të cilat për 677 raste është miratuar lista përfundimtare, ndërkohë pjesa e mbetur janë në fazë paraprake.



Nga lista e asetëve të transferuara, rezulton se Bashkia Lezhë ka marrë masa dhe ka regjistruar e pajisur me certifikatë në ZVRPP Lezhë 539 asete ose 12% të asetëve. Për asetet e mbetura, nuk është kryhet një inventarizim periodik, duke mos patur informacion as për gjendjen e tyre, nëse janë ende ekzistente, të zaptuara, privatizuara, etj. Për këto asete nuk ka një pasqyrimin real dhe të drejtë të vlerës së tyre në pasqyrat financiare, nuk ka një vlerësimin fizik, identifikim të mangësive apo humbjeve, vlerësim monetar, si dhe krijimin e regjistrit kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë.

Për kryerjen e detyrave të mësipërme Bashkia Lezhë nuk ka as një strukturë të posatshme, por funksionon nëpërmjet sektorit bujqësor dhe atij të asetëve të cilat mbajnë vetëm disa të dhëna bazike. Lista e asetëve të regjistruara të Bashkisë në aneksin bashkëlidhur.

Ndërkohë sa i takon asetëve të llojeve kullota/pyje transferuar sipas VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive”, rezulton se Bashkisë Lezhë i janë transferuar asete sipas shtojcës nr. 42, me numër rendor 1-1093 si vijon:

**Gjithsej 20796.94 ha, nga këto:**

- Pyje 18857.83 ha
- Kullotë 1936.2 ha
- Toka joproductive 136.9 ha
- Shkëmbore 2866.01 ha

Për të gjithë sipërfaqet e mësipërme rezulton se që nga momenti i transferimit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, është kontraktuar kompania private DATECH, e cila ka përgatitur dokumentacionin e nevojshëm teknik për aplikimet e nevojshme për regjistrimin fillestar, por procesi ende nuk është përfunduar dhe Bashkia nuk është e pajisur me certifikatat përkatëse.

Ndërkohë rezulton se Bashkia Lezhë, aktualisht është në process miratimi të Planit të Menaxhimit për 1 ekonomi pyjore.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” nenin 18, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, pikën 18, 22, me ligjin nr.20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV “Përditësimi, inventarizimi, transferimi dhe rregjistrimi i pronave të paluajtshme publike”nenet 35-44, me Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”dhe VKM-së nr.669, datë 07.08.2013 ”Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGJSH)”.

Nga asetet e mësipërme rezulton se Bashkia Lezhë për vitin 2023 nuk ka lidhur kontrata qiraje për dhënie në përdorim të hapësirave në pronësi, por ka patur në fuqi kontrata të lidhura më parë si vijon:

1. Qiramarrësi K. O. në zonën e Malit të Zadrimës me objekt kontrate vendosje anemometri për matjen e erës me afat 2 vite me nr. kontrate 16348/3 datë 01.10.2021.

1 ha cungishte x 96,000 lek/ha/vit x 2 vjet = 192,000 lekë.

1 ha shkurre x 96,000 lekë/ha/vit x 2 vjet = 192 000 lekë.

**Vlera totale e kontratës për dy vjet është 384,000 lekë, vlerë e cila është arkëtuar e gjitha.**

2. Qiramarrësi G. në zonën e Malit të Rrencit, me objekt rehabilitim rruga Shëngjin–Baks-Rrjoll me nr. kontrate 13392/1 datë 02.12.2021 për 2 vite.

a) Vlera e përdorimit të rrugës lek/km/vit:

1.91 km x 70,000 lek/km/vit x 2 vjet = 267,400 lekë.

1.34 km x 50,000 lek/km/vit x 2 vjet = 134,000 lekë.

0.83 km x 35,000 lekë/km/ vit x 2 vjet = 58,100 lekë.

0.43 km x 35,000 lekë/km/vit x 2 vjet = 30,100 lekë.

1.40 km x 25,000 lekë/m/vit x 2 vjet = 70,000 lekë.

b) Vlera e lëndës drusore që do të pritët:

Lëndë punimi 26.97 m<sup>3</sup> x 2300 lekë = 62,031 lekë.

Dru zjarri 26.89 m<sup>3</sup> x 200 lekë = 5,378 lekë.

Dru zjarri 99.05 m<sup>3</sup> x 500 lekë = 49,525 lekë.

**Vlera Totale e (a+b) kontratës për dy vjet është 676,534 lekë, vlerë e cila është arkëtuar plotësisht**

3. Qiramarrësi K. O. me vendodhje në Malin e Zadrimës, me objekt kontrate vendosje anemometri për matjen e erës, me afat 2 vite me nr. kontrate 2733/2 datë 19.04.2022.

a) Vlera e sipërfaqes së dhënë në përdorim lek/ha/vit.

1Ha x 76,800 lek/ha/vit x 2 vjet 153,600 lekë.

b) Vlera e përdorimit të rrugës lek/km/vit.

1.1 km x 35,000 lek/km/vit x 2 vjet = 77,000 lekë.

0.9 km x 25,000 lek /km/vit x 2 vjet = 45,000 lekë.

c) Vlera e lëndës drusore që do të pritët: nuk do hiqet material drusor në këto sipërfaqe.

**Vlera totale e kontratës = 275,600 lekë, vlerë e cila është arkëtuar e gjitha.**

Nga auditimi i kësaj kontrate, rezulton se për përcaktimin e vlerës është marrë çmimi për dhënien e sipërfaqes pyjore prej 76,800 lekë, vlerë e cila i korrespondon kategorisë 9, për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objektesh të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe, ndërkohë që për këtë përllogaritje, çmimi duhet të referohej kategorisë 8, për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linje të tensionit, aerogeneratorë (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj, në vlerën 150,000 lekë, pasi objekti i kontratës bën fjalë për ngritje impianti dhe jo zbulim elementësh. Përllogaritja e saktë e vlerës së sipërfaqes duhej të ishte 1ha x 150,000 lek/ha/vit x 2 vjet = 300,000 lekë dhe vlera totale e kontratës 422,000 lekë ose 146,400 lekë më tepër se sa është përllogaritur.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me lidhjen 2 të VKM nr. nr.1064, datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të këshillit të ministrave "për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave".

Po kështu, nga auditimi rezultoi se nga Njësia e Administrimit të Pyjeve nuk kryhet një punë korrekte në mbajtjen dhe administrimin e të dhënave lidhur me dhënien me qera të sipërfaqeve pyjore apo kullosore, duke mos ndjekur dhe mbikëqyrur zbatimin e kontratave të dhëna për shfrytëzimin e fondit pyjor dhe kullosor. Nga kjo njësi mbahen vetëm fizikisht kontratat e lidhura

dhe nuk mbahet asnjë databazë me të dhëna të detajuara mbi kontratat, datën e lidhjes së tyre, afatet, shlyerjen e detyrimeve dhe vlerën e atyre të mbetura.

Pavarësisht kërkesave të njëpasnjëshme të grupit të auditimit, nga sektori i administrimit të pyjeve u vunë në dispozicion vetëm 3 kontratat e mësipërme dhe i gjithë informacioni tjetër u arrit të verifikohet nëpërmjet sektorit të financës me të dhënat e tyre. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikën 2/u të paragrafit 48.3, të nenit 48 të Rregullores së Brendshme të Bashkisë Lezhë.

*Për sa më lart është mbajtur Akt konstatimi nr. 4 me z. P. N., z. E. S., z. A. P., z. Gj. M., z. Y. P. dhe znj. D. U..*

## **5.TË NDRYSHME TË DALA GJATË AUDITIMIT - ANKESË**

Në zbatim të pikes 5 të programit të auditimit: *“Të ndryshme të dala gjatë auditimit”* u shqyrtua ankesa e mbërritur në adresën zyrtare elektronik të KLSH si më poshtë:

Më datë 06.09.2024, subjekti E. M., në cilësinë e administratorit të aktivitetit të biznesit në fushën e hotelerisë, me NIPT L.....L, ka parashtruar pretendimet për tarifim të kundraligjshëm mbi aktivitetin e biznesit që drejton dhe konkretisht:

Në zbatim të VKB nr. 64, datë 31.10.2023, *“Për miratimin e nivelit të Taksave dhe Tarifave Vendore....”*, më datë 05.08.2024, z. M. ka dorëzuar librin e fjetjes për muajin korrik 2024, në bazë të të cilit nga njësia e taksave dhe tarifave vendore pranë Bashkisë përllorëgjariten detyrimet përkatëse mujore. Në vijim, me shkresë nr. 13465, datë 07.08.2024 të Bashkisë Lezhë, z. M. është njoftuar për vlerën e detyrimeve nga *“Taksa e fjetjes në hotel”* prej 163,800 lekë, për të cilën pretendon se është vendosur në kundërshtim me VKB nr. 64, datë 31.10.2023, *“Për miratimin e nivelit të Taksave dhe Tarifave Vendore....”*, me arsyetimin se libri i fjetjes është dorëzuar vetëm për muajin korrik pasi për 5 ditët e funksionimit të aktivitetit të tij që nga data 26.06.2024, nuk ka patur klientelë. Mos dorëzimi i librit të fjetjes për periudhën qershor, arsyetohet me pretendimin se dihet nga media që kjo periudhë nuk ka patur pushues, si dhe me pretendimin se VKB e mësipërme nuk detyron dorëzimin e librit të fjetjes nëse nuk ka aktivitet dhe dorëzimi i tij në këtë rast nuk ka sens logjik.

Nga verifikimi i grupit të auditimit rezultoi se:

Për aktivitetin në fjalë, vlera e taksës së fjetjes e miratuar sipas VKB përkatëse është 70 lekë/person/natë, vlerë e cila përllorëgjaritet në bazë të numrit të personave të regjistruar në librin e fjetjes, si dhe numrit të netëve për secilin prej tyre, dokument i cili dorëzohet pranë Bashkisë Lezhë brenda datës 5 të muajit pasardhës. Subjekti në fjalë ka ri aktivizuar aktivitetin më datë 26.06.2024, referuar Ekstraktit Historik të QKB dhe ka dorëzuar librin e fjetjes vetëm për muajin korrik, me procesverbal datë 05.08.2024 në prani të specilistes për taksat dhe tarifat.

Për sa më lart, konstatohet se subjekti E. M. nuk ka dokumentuar pranë Bashkisë Lezhë në asnjë formë faktin se për periudhën 26.06.2024 – 01.07.2024 nuk ka patur asnjë klient të regjistruar, qoftë kjo me dorëzimin e librit të fjetjes të pa plotësuar që nga momenti i tërheqies së tij pranë Bashkisë referuar numrave serialë, apo me vetëdeklarim. Nisur nga ky fakt, paragrafi A.3.5.1 i VKB nr. 64, datë 31.10.2023, *“Për miratimin e nivelit të Taksave dhe Tarifave Vendore....”* përcakton se *Në rastet kur, “Regjistri i fjetjes” nuk paraqitet fare, atëherë Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka të drejtë të bëjë vlerësim alternativ, duke marrë për bazë numrin e dhomave që subjekti ka në shfrytëzim të aktivitetit si hoteleri, me një numër minimal prej 2 personash për çdo dhomë, me bazë ditore për 90 ditë kalendarike, që subjekti është aktiv në sistemin tatimor.*

Për sa më lart, së pari në mungesë të dorëzimit të regjistrit për muajin qershor, Bashkia Lezhë ka përdorur mënyrën alternative të vlerësimit si më lart cituar, sipas së cilës detyrimi i subjekti që nuk ka dorëzuar librin e fjetjes vlerësohet me bazë 90 ditore për sezonin veror që ai operon dhe nuk faturohet më në vijim, duke përlllogaritur një vlerë detyrimi prej 163,800 lekë (13 dhoma x 2 persona/dhomë x 70 lekë/person x 90 ditë kalendarike).

Nga shqyrtimi i dosjes së vënë në dispozicion për këtë subjekt rezulton se, verifikimi i fundit në terren nga Bashkia Lezhë është kryer në muajin gusht 2022, ku ka rezultuar se subjekti në fjalë zotëron 12 dhoma fjetje dhe nuk ka të dhëna të tjera për verifikime të kryera gjatë vitit 2023, pra vlera e detyrimit duhej të ishte 151,200 lekë (12 dhoma x 2 persona/dhomë x 70 lekë/person x 90 ditë kalendarike). Ndërkohë konstatohet se vlerësimi alternativ nga Bashkia është përlllogaritur për 13 dhoma. Për këtë arsye, grupet e terrenit duhet të bëjnë verifikimin në vend dhe të saktësojnë numrin e dhomave të subjektit, duke vijuar me ri përlllogaritjen e detyrimit në varësi të numrit të dhomave sipas vlerësimit alternativ.

Së dyti, për sa kohë VKB parashikon një formë “penalizimi” për rastet kur libri i fjetjes nuk dorëzohet, nuk përbën argument të shëndoshë dhe as evidencë për përlllogaritje taksash e tarifash, pretendimi se dihet nga media që kjo periudhë nuk ka patur pushues, si dhe VKB e mësipërme nuk detyron dorëzimin e librit të fjetjes nëse nuk ka aktivitet.

Krahas sa më lart, nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosje, konstatohen gjithashtu mangësi nga ana e subjektit në fjalë, së pari referuar akt konstatimit të mbajtur më datë 18.08.2022 në terren, ku ka rezultuar se subjekti regjistron në librin e fjetjes vetëm kryefamiljarin dhe së dyti referuar librit të fjetjes së dorëzuar për muajin korrik 2024, ku konstatohet se regjistri nuk është mbajtur i rregullt pasi në shumë raste përsëri nuk identifikohet personi që shoqëron kryefamiljarin, por për të përdoret simboli “si më lart” dhe nuk numërohet si natë fjetje.

Po kështu, vihet re se përgjatë të gjithë muajit korrik janë regjistruar i njëjti grup personash, emrat e të cilëve përsëriten disa herë në data të ndryshme dhe në kolonën e nënshkrimit të klientit evidentohet pothuasje e njëjta firmë. Të gjithë elementët e mësipërm nuk garantojnë sigurinë e arsyeshme se subjekti në fjalë operon dhe dokumenton me korrektësi aktivitetin e tij.

*Për sa më lart është mbajtur Akt verifikimi nr. 1 me z. P. N. dhe z. D. P.*

### **III. GJETJE DHE REKOMANDIME**

#### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në Bashkinë Lezhë funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit ka shfaqur mangësi, duke bërë që sistemet e kontrollit mos të funksionojnë plotësisht në këto drejtime:

##### “Mjedisi i kontrollit”

-Bashkia Lezhë nuk ka miratuar një Kod të Etikës, por në nenin 27 e në vijim të Rregullores së Brendshme të kësaj Bashkie është përfshirë edhe “Etika për punonjësit e Bashkisë Lezhë dhe kodi i veshjes”.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka asnjë plan menaxhimi për veprime korigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.

- Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm”.

#### “Menaxhimi i Riskut”

Në bashkinë Lezhë nuk është hartuar regjistri i riskut, në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 për “menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 11 dhe neni 12. Për periudhën objekt auditimi nuk ka një strategji të miratuar të riskut ku të përcaktohet mënyra se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut.

Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. Në rregulloren e brendshme nuk janë përfshira detyrat dhe përgjegjësit e koordinatorit të riskut, dhe grupit të menaxhimit të riskut.

#### “Aktivitetet e Kontrollit”

- Bashkia Lezhë nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

-Bashkia Lezhë nuk ka hartuar, miratuar dhe arkivuar gjurmën e auditimit e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre dhe synon të ripërshkrojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to.

#### “Informimi dhe komunikimi”

- Në Bashkinë Lezhë aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Planet e Menaxhimit dhe Raportet e Zbatimit, mungojnë Indikatorët e Performancës si dhe Komiteti i Auditimit. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 10-23 të Raportit të Auditimit).*

**1.1. Rekomandimi:** Menaxhimi i lartë i Bashkisë Lezhë, të marrë masat të ngrejë një sistem efektiv të mjedisit të kontrollit, të hartojë strategjinë e vlerësimit dhe parandalimit të riskut në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, si dhe të hartojë procedura dhe rregulla të shkruara në lidhje me frekuencën e raportimit për monitorimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

### **Brenda vitit 2025**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në Bashkinë Lezhë u konstatua se Njësia e Auditit të Brendshëm është e organizuar në nivel sektori me 3 punonjës nga të cilët 2 (dy) specialist janë të certifikuar dhe një (1) i pa certifikuar në funksionin e Përgjegjësit të Sektorit, në kundërshtim me pikën b dhe ç të nenit 11, si dhe nenin 19 të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Gjithashtu, konstatohet se Bashkia Lezhë nuk ka të ngritur Komitetin e Auditimit të Brendshëm të njësisë publike, sipas pikës 3, të Kreut III, të VKM nr.160, datë 02.03.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm të njësisë publike”. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 10-23 të Raportit të Auditimit).*

**2.1.Rekomandim:** Përgjegjësi i sektorit të Njësies së Auditit të Brendshëm, të marrë masa për nisjen e procedurës së certifikimit si “Auditues i brendshëm në sektorin publik” në funksion të përmbushjes së misionit të kësaj njësie, si dhe në bashkëpunim me Titullarin e Bashkisë, të merren masa për ngritjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

## Menjëherë

**3. Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2023 planifikimi total i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën 3,203,717 mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën 2,436,432 mijë lekë, ose në masën 76.1%. Nga këto janë realizuar nga të ardhurat e veta 1,332,619 mijë lekë dhe vlera e mbuluar nga FZHR dhe granti është 1,103,813 mijë lekë. Nga auditimi rezulton se ndër zërat që paraqiten me mos realizim janë: shpenzimet operative, realizuar në masën 67.5%, ose 139,398 mijë lekë më pak se plani, për shkak të mungesës së likujditeteve si pasojë e mos realizimit të të ardhurave, pasi këto shpenzime mbulohen kryesisht nga të ardhurat e veta, si dhe transfertat korrente të brendshme realizuar në masën 50% dhe fondi rezervë dhe i kontigjencës realizuar në masën 8.5%, si pasojë e mos përdorimit të plotë të fondit akorduar për emergjencat civile. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 47, ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 44 dhe VKB nr. 120, datë 02.12.2022, "Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe Buxhetin Vjetor 2023". *(Trajtuar më hollësisht në faqet 23-40 të Raportit të Auditimit).*

**3.1 Rekomandimi:** Bashkia Lezhë të analizojë dhe të marrë masa për hartimin e një buxheti real dhe objektiv sa i takon nevojave për shpenzimeve, duke mbajtur parasysh edhe mundësitë që ka, si dhe treguesit historik në arkëtimin e të ardhurave, me qëllim shmangien e diferencave midis parashikimit dhe realizimit të shpenzimeve të planifikuara.

## Në vijimësi

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi përllogaritjen e vështirësisë financiare, rezulton se për këtë tregues, Bashkia Lezhë ka raportuar si shpenzime vjetore faktike vlerën prej 1,875,828 mijë lekë që në fakt është vlera e shpenzimeve të planifikuara dhe jo e atyre faktike. Sipas raportimit të Bashkisë Lezhë në MFE me anë të e-mail dhe po kështu nëpërmjet raportimit të buxhetit faktik me shkresë nr. 1849, datë 12.04.2024, me këto të dhëna rezulton se vështirësia financiare është 8.81%. Pavarësisht përllogaritjes së vështirësisë financiare mbi raportin e shpenzimeve plan dhe jo atyre fakt, gjithsesi Bashkia Lezhë klasifikohet në Bashki pa vështirësi financiare, pasi referuar përllogaritjes sipas udhëzimeve të MFE, rezulton se vështirësia financiare për Bashkinë Lezhë është 12%. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me paragrafin 59 të Udhëzimit nr. 35, datë 29.12.2023, "Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore". *(Trajtuar më hollësisht në faqet 23-40 të Raportit të Auditimit).*

**4.1 Rekomandimi:** Sektori i Hartimit dhe Zbatimit të Buxhetit, të analizoje dhe të marrë masa që në përllogaritjen e treguesit të vështirësisë financiare të Bashkisë, të aplikojë vlerën e shpenzimeve faktike dhe jo atyre të planifikuara.

## Në vijimësi

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi pronat dhe astete e transferuara Bashkive, rezulton se Bashkia Lezhë zotëron në total 4473 asete, nga të cilat për 677 raste është miratuar lista përfundimtare, ndërkohë pjesa e mbetur janë në fazë paraprake. Nga lista e aseteve të transferuara, rezulton se Bashkia Lezhë ka marrë masa dhe ka regjistruar e pajisur me çertifikatë në ZVRPP Lezhë 539 asete ose 12% të aseteve. Për asetet e mbetura, nuk kryhet një inventarizim periodik, duke mos patur informacion as për gjendjen e tyre, nëse janë ende ekzistente, të zaptuara, privatizuara, etj. Për këto asete nuk ka një pasqyrimin real dhe të drejtë të vlerës së tyre në pasqyrat financiare, nuk ka një vlerësimin fizik, identifikim të mangësive apo humbjeve, si dhe krijimin e

regjistrin kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë. Për kryerjen e detyrave të mësipërme Bashkia Lezhë nuk ka as një strukturë të posatshme, por funksionon nëpërmjet sektorit bujqësor dhe atij të aseteve të cilat mbajnë vetëm disa të dhëna bazike. Ndërkohë sa i takon aseteve të llojeve kullota/pyje transferuar sipas VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive”, rezulton se Bashkisë Lezhë i janë transferuar gjithsej 20796.94 ha, nga këto Pyje 18857.83 ha, Kullotë 1936.2 ha, Toka joproduktive 136.9 ha dhe Shkëmbore 2866.01 ha. Për të gjithë sipërfaqet e mësipërme rezulton se që nga momenti i transferimit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, është kontraktuar kompania private DATECH, e cila ka përgatitur dokumentacionin e nevojshëm teknik për aplikimet e nevojshme për regjistrimin fillestar, por procesi ende nuk është përfunduar dhe Bashkia nuk është e pajisur me certifikatat përkatëse. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 55-69 të Raportit të Auditimit).*

**5.1 Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Lezhë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për identifikimin e gjendjes së aseteve të mbetura pa regjistruar të cilat i janë transferuar në pronësi në mënyrë përfundimtare, si dhe të fillojë përgatitja e dokumentacionit tekniko ligjor të secilit prej tyre për të vijuar me aplikimet përkatëse për pajisje me certifikatë pronësie.

**Në vijimësi**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i ankesës së subjektit E. M., administrator biznesi në fushën e hotelierisë, lidhur me pretendimet për tarifim të kundraligjshëm për aktivitetin që drejton, me arsyetimin se libri i fjetjes është dorëzuar vetëm për muajin korrik pasi për 5 ditët e funksionimit në muajin qershor, nuk ka patur klientelë VKB për paketën fiskale nuk detyron dorëzimin e librit të fjetjes nëse nuk ka aktivitet, rezultoi se për aktivitetin në fjalë, vlera e taksës së fjetjes e miratuar sipas VKB përkatëse është 70 lekë/person/natë, vlerë e cila përlllogaritet në bazë të numrit të personave të regjistruar në librin e fjetjes, si dhe numrit të netëve për secilin prej tyre, dokument i cili dorëzohet pranë Bashkisë Lezhë brenda datës 5 të muajit pasardhës. Subjekti në fjalë ka ri aktivizuar aktivitetin më datë 26.06.2024, referuar Ekstraktit Historik të QKB dhe ka dorëzuar librin e fjetjes vetëm për muajin korrik, me procesverbal datë 05.08.2024 në prani të specialistes për taksat dhe tarifatat. Për sa më lart, konstatohet se subjekti E. M. nuk ka dokumentuar pranë Bashkisë Lezhë në asnjë formë faktin se për periudhën 26.06.2024 – 01.07.2024 nuk ka patur asnjë klient të regjistruar, qoftë kjo me dorëzimin e librit të fjetjes të pa plotësuar që nga momenti i tërheqjes së tij pranë Bashkisë referuar numrave serialë, apo me vetëdeklarim. Nisur nga ky fakt, paragrafi A.3.5.1 i VKB nr. 64, datë 31.10.2023, “Për miratimin e nivelit të Taksave dhe Tarifave Vendore....” përcakton se *Në rastet kur, “Regjistri i fjetjes” nuk paraqitet fare, atëherë Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka të drejtë të bëjë vlerësim alternativ, duke marrë për bazë numrin e dhomave që subjekti ka në shfrytëzim të aktivitetit si hoteleri, me një numër minimal prej 2 personash për çdo dhomë, me bazë ditore për 90 ditë kalendarike, që subjekti është aktiv në sistemin tatimor.* Për sa më lart, së pari në mungesë të dorëzimit të regjistrin për muajin qershor, Bashkia Lezhë ka përdorur mënyrën alternative të vlerësimit si më lart cituar, sipas së cilës detyrimi i subjekti që nuk ka dorëzuar librin e fjetjes vlerësohet me bazë 90 ditore për sezonin veror që ai operon dhe nuk faturohet më në vijim, duke përlllogaritur një vlerë detyrimi prej 163,800 lekë (13 dhoma x 2 persona/dhomë x 70 lekë/person x 90 ditë kalendarike). Nga shqyrtimi i dosjes së vënë në dispozicion për këtë subjekt rezulton se, verifikimi i fundit në terren nga Bashkia Lezhë është kryer në muajin gusht 2022, ku ka rezultuar se subjekti në fjalë zotëron 12 dhoma fjetje dhe nuk ka të dhëna të tjera për verifikime të kryera gjatë vitit 2023, pra vlera e detyrimit duhej të ishte 151,200 lekë (12 dhoma x 2 persona/dhomë x 70 lekë/person x 90 ditë kalendarike). Ndërkohë

konstatohet se vlerësimi alternativ nga Bashkia është përlogaritur për 13 dhoma. Krahas sa më lart, nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosje, konstatohen gjithashtu mangësi nga ana e subjektit në fjalë, së pari referuar akt konstatimit të mbajtur më datë 18.08.2022 në terren, ku ka rezultuar se subjekti regjistron në librin e fjetjes vetëm kryefamiljarin dhe së dyti referuar librit të fjetjes së dorëzuar për muajin korrik 2024, ku konstatohet se regjistri nuk është mbajtur i rregullt pasi në shumë raste përsëri nuk identifikohet personi që shoqëron kryefamiljarin, por për të përdoret simboli “si më lart” dhe nuk numërohet si natë fjetje. Po kështu, vihet re se përgjatë të gjithë muajit korrik janë regjistruar i njëjti grup personash, emrat e të cilëve përsëriten disa herë në data të ndryshme dhe në kolonën e nënshkrimit të klientit evidentohet pothuasje e njëjta firmë. Të gjithë elementët e mësipërm nuk garantojnë sigurinë e arsyeshme se subjekti në fjalë operon dhe dokumenton me korrektësi aktivitetin e tij. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 69-71 të Raportit të Auditimit).*

**6.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për kryerjen e verifikimit në vend të subjektit E. M. me numër identifikimi L.....L dhe të saktësojnë numrin e dhomave, duke vijuar me ri përlogaritjen e detyrimit sipas vlerësimi alternativ, në varësi të numrit të dhomave të konstatuara në terren.

#### Menjëherë

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Lezhë më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 138,604,257 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 173,727,767 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Për 31 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Lezhë janë ngurtësuar fonde në vlerën 12,277,346 lekë për të cilat nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Lezhë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimi të Territorit dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 12,277,346 lekë.

Veprime këto në kundërshtim me udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.3, faqe 40-55 të Raportit të Auditimit).*

**7.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

#### Menjëherë dhe në vijimësi

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se gjendja e llogarisë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” është paraqitur në vlerën 102,665,632 lekë kjo llogari nuk ka pasur shtesa gjatë vitit 2023. Llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në datën 31.12.2023 paraqitet në vlerën 3,805,335,333 lekë, gjatë vitit 2023 kjo llogari ka pasur shtesa në shumën 677,931,605 lekë. Bashkia Lezhë për llogarinë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale”



nuk i ka vendosur grupi të auditimit një listë analitike për projektet të cilat janë të kontabilizuara në këtë llogari. Për llogarinë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” grupit të auditimit i janë vendosur në dispozicion vetëm procedurat e prokurimit për periudhën 2020-2023, operatorët e shpallur fitues dhe vlerën e kontratës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin Nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.8, datë 09.03.2018” kontabilizohen shpenzime për aktive afatgjata në proces dhe në momentin e përfundimit të projektit dhe marrjes në dorëzim këto investime kontabilizohen në klasën 2 të aktivitetit. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.3, faqe 40-55 të Raportit të Auditimit).

**8.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë duhet të ngrejë një grup pune për zbrëthimin dhe analizimin e projekteve të kontabilizuara në llogaritë 230 - 231 “Investime në proces” dhe për projektet të cilat janë përfunduar të kryhen sistemet kontabël.

**Me mbylljen e PF të vitit 2024**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Lezhë, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 165,278,352 lekë. Kontabilizimi i detyrimeve të prapambetura në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është kryer në kundërshtim me udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.3, faqe 40-55 të Raportit të Auditimit).

Referuar udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, kjo llogari përpara mbyllje së llogarive vjetore duhet të kryejë mbylljen e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në debi të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

**9.1.Rekomandimi:**Drejtoria e Financës të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

**Me mbylljen e PF të vitit 2024**

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se: Llogaria 101 “Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar” sipas udhëzimit të MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” kreditohet nga investimet, dhurimet dhe pakësohet nga amortizimi i vitit dhe nxjerrjet jashtë përdorimit. Llogaria 101 “Teprica” është regjistruar në datë 01.01.2023 për vlerën 6,328,164,500 lekë, gjatë vitit 2023 ka pasur shtesa në vlerën 85,795,020 lekë nga investimet dhe dhurimet, pakësimet kanë qënë në vlerën 326,340,660 lekë nga amortizimi i vitit dhe nxjerrjet nga përdorimi.Në datë 31.12.2023 kjo llogari është pasqyruar për vlerën 6,085,647,215 lekë.

Sipas analizës së mësipërme llogaria 101 është raportuar në bilanc e mbivlerësuar për vlerën 825,112 lekë në kundërshtim me udhëzimin e MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.3, faqe 40-55 të Raportit të Auditimit).

**10.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 “Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar” për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

**Me mbylljen e PF të vitit 2024**

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se: Llogaria.202 “Studime dhe Kërkime”, dhe paraqiten me kosto historike 38,396,671 lekë, amortizim të akumuluar në vlerën 26,477,871 lekë dhe vlerë neto 11,918,800 lekë. Kjo llogari nuk është e analizuar dhe nuk ka informacion çfarë projekte janë përfshirë në këtë llogari. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.3, faqe 40-55 të Raportit të Auditimit).

**11.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë duhet të ngrejë një grup pune për zberthimin dhe analizimin e projekteve të kontabilizuara në llogaritë 202 “Studime dhe Kërkime” për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

**Me mbylljen e PF të vitit 2024**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se: Llogaria 467 “Kreditore të ndryshëm”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Lezhë, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 165,278,352 lekë dhe përfaqëson vlerën e detyrimeve të Bashkisë Lezhë për kontratat e investimeve. Gjatë vitit 2023 kjo llogari është shtuar me vlerën 75,447,313 lekë. Llogaria 467 “Kreditore të ndryshëm” është mbivlerësuar për vlerën 33,615,932 lekë e cila përbëhet prej 8 faturave tatimore për mallra. Këto fatura janë regjistruar në llogarinë 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”, Regjistrimi në llogarinë 467 ka sjell pasqyrim jo real të llogarive kontabël. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.3, faqe 40-55 të Raportit të Auditimit).

**12.1 Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 467 “Kreditore të ndryshëm” për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

**Me mbylljen e PF të vitit 2024**

## **B. MASA PËR RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga të dhënat e Bashkisë Lezhë, rezulton se vlera totale debitore në fund të vitit 2022 është 246,341,820 lekë. Vlera e krijuar bashkë me kamatëvonesat gjatë vitit 2023 është 252,101,243 lekë, ndërkohë që janë arkëtuar detyrime në vlerën 220,407,811 lekë, nga ku rezulton se vlera debitore në fund të 2023 është 278,035,252 lekë, që përbën detyrim për arkëtim, duke qenë se e gjithë vlera e mësipërme është njohur dhe kontabilizuar. Vlera debitore e mësipërme përbëhet nga:

- debitorë për taksën e fjetjes në hotel në vlerën 6,236,280 lekë
- debitorë që ushtrojnë aktivitet tregtim lëndë djegëse në vlerë 2,000,000 lekë
- debitorë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 12,219,709 lekë, si dhe
- debitorë nga biznes i madh, biznes i vogël dhe debitorë familjar në vlerën prej 257,579,263 lekë, për të cilët Bashkia nuk i ka të identifikuar sipas kategorive dhe llojit të taksës sepse nuk operon me agjentë tatimorë dhe as nuk ka kryer verifikime në terren. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e VKB-në nr. 112, datë 31.10.2022, “Për miratimin e nivelit të taksave, tarifave vendore për shërbimet publike dhe ato administrative, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penalteteve ndaj kundërvajtësve” pika A dhe B, me ligjin

nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10. (Trajtuar më hollësisht në faqet 23-40 të Raportit të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për të krijuar një data bazë me të dhëna të detajuara për bizneset dhe qytetarët sipas llojeve dhe vlerave të detyrimeve tatimore të krijuara prej tyre vit pas viti.

#### **Brenda vitit 2025**

**1.2 Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Lezhë të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në vlerën 278,035,252 lekë.

#### **Në vijimësi**

### **C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, SI DHE NGA QIRADHËNIA, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kontratave të qirave, rezulton se është lidhur kontrata nr. 2733/2, datë 19.04.2022, me qiramarrës K. O., me objekt kontrate vendosje anemometri për matjen e erës, me afat 2 vite. Vlera totale e kontratës prej 275,600 lekë, është përlllogaritur si vijon:

a) Vlera e sipërfaqes së dhënë në përdorim lek/ha/vit.

1Ha x 76,800 lek/ha/vit x 2 vjet 153,600 lekë.

b) Vlera e përdorimit të rrugës lek/km/vit.

1.1 km x 35,000 lek/km/vit x 2 vjet = 77,000 lekë.

0.9 km x 25,000 lek /km/vit x 2 vjet = 45,000 lekë.

c) Vlera e lëndës drusore që do pritët: nuk do hiqet material drusor në këto sipërfaqe.

Nga auditimi i kësaj kontrate, rezulton se për përcaktimin e vlerës është marrë çmimi për dhënien e sipërfaqes pyjore prej 76,800 lekë, vlerë e cila i korrespondon kategorisë 9, për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objektsh të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe, ndërkohë që për këtë përlllogaritje, çmimi duhet ti referohej kategorisë 8, për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linje të tensionit, *aerogjeneratorë (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj)*, në vlerën 150,000 lekë, pasi objekti i kontratës bën fjalë për ngritje impianti dhe jo zbulim elementësh. Përlllogaritja e saktë e vlerës së sipërfaqes duhej të ishte 1ha x 150,000 lek/ha/vit x 2 vjet = 300,000 lekë dhe vlera totale e kontratës 422,000 lekë ose 146,400 lekë më tepër se sa është përlllogaritur. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me lidhjen 2 të VKM nr. nr.1064, datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të këshillit të ministrave "për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave". (Trajtuar më hollësisht në faqet 23-40 të Raportit të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** Nga sektori juridik në Bashkinë Lezhë, te merren masa për rishikimin dhe saktësimin e vlerës totale të kontratës nr. 2733/2, datë 19.04.2022, sipas kategorisë 8, për ndërtim aerogjeneratorë (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatësej), si dhe arkëtimin e diferencës prej 146,400 lekë nga mos përlllogaritja e saktë e kësaj vlere.

#### **Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se nga vlera totale debitore prej 12,219,709 lekë e krijuar nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, është njohur dhe dërguar pranë degës së financës për kontabilizim vetëm vlera prej 5,866,613 lekë, duke bërë që diferenca prej 6,353,096 lekë e pa

kontabilizuar të konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Lezhë. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3.c dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5. Pika 5 e nenit 27 të ligjit 9632 datë 30.10.2006 “për sistemin e taksave dhe tarifave vendore”. (Trajtuar më hollësisht në faqet 23-40 të Raportit të Auditimit).

**2.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për kontabilizimin dhe arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet që janë legalizuar me vlerë 6,353,096 lekë.

**Në vijimësi**

#### **D. MASA DISIPLINORE**

Për të gjithë punonjësit trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga KLSH-ja nuk është rekomanduar dhënia e masës disiplinore konkrete, pasi shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara janë nën materialitetin e përcaktuar nga grupi i auditimit. **Lihet në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë Lezhë**, fillimi ose jo i procedurave disiplinore në referim të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në kontratën individuale të punës.

*Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.*

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**